




**RAPORTI I MONITORIMIT TË
ZBATIMIT TË DETYRIMEVE
LIGJORE TË SIGURIMIT
TË TRANSPARENCËS DHE
PROCESIT TË KONSULTIMIT
PUBLIK NGA BASHKITË**

RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË DETYRIMEVE LIGJORE TË SIGURIMIT TË TRANSPARENCËS DHE PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK NGA BASHKITË



Përmbajtja

HYRJE	5	1.4. Analizë Krahësuese	24
RAPORTI 2025	6	1.5. Publikimi dhe përditësimi i të dhënave mbi projektet e financuara nga fondet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare.	25
1. TRANSPARENCA.....	6	1.5.1. Faza Përgatitore	25
1.1. Metodologjia	6	1.5.2. Analizimi i Gjetjeve	25
1.2. Parashikimet ligjore të indikatorëve të monitoruar	8	1.5.3. Rekomandime/Përfundime	29
1.3. Gjetjet për Secilën prej Bashkive (Indikatorët e Transparencës).....	10	2. MONITORIMI I PREMTIMEVE	30
1.3.1. Bashkia Durrës	10	2.1. Premtimet e Monitoruara	31
1.3.2. Bashkia Tiranë.....	11	2.2. Gjetjet për Secilën prej Bashkive.....	33
1.3.3. Bashkia Shkodër.....	13	Konkluzione	37
1.3.4. Bashkia Sarandë.....	14	3. FONDI SOCIAL	38
1.3.5. Bashkia Lezhë	15	Aneks 1 Lista e Projekteve Bashkia Shkodër.....	57
1.3.6. Bashkia Korçë.....	17	Aneks 2 Lista e Projekteve Bashkia Shkodër.....	58
1.3.7. Bashkia Fier.....	18	Aneks 3 Lista e Projekteve Bashkia Fier.....	61
1.3.8. Bashkia Kavajë	19	Aneks 4 Lista e Projekteve Bashkia Vlorë.....	62
1.3.9. Bashkia Vlorë.....	21		
1.3.10. Bashkia Elbasan.....	22		

Lista e tabelave

Tabela 1 - Projekti 1: “Qendra Multifunkionale Shushicë”	
Tabela 2 - Projekti 2: “Fit për Jetën” (shërbim i ri në 2025)	
Tabela 3 - Projekti 1: “Ngritja e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen me bazë komunitare (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)”	
Tabela 4 - Projekti 2: “Qendër Ditore për të Moshuarit”	
Tabela 5 - Kategoritë e përfituesëve sipas çdo bashkie	

Lista e figurave

Figura 1 - Vlera totale e financuar e Fondit Social për vitet 2023-2025.	
Figura 2 - Shërbime totale 2023 - 2025 (bashki përfituese).....	
Figura 3 - Viti aktual i zbatimit të fondit social	
Figura 4 - Vlera e financuar për Bashkitë në monitorim sipas vitit respektiv.....	

HYRJE

Projekti “40 premtime, 10 bashki” është i mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED) dhe është implementuar nga Qendra Faktoje. Synimi i këtij projekti është monitorimi i bashkive sa i përket mbajtjes së premtimeve dhe transparencës. Gjatë vitit të shkuar projekti përfshiu bashkitë e Dibrës, Elbasanit, Fierit, Kavajës, Durrësit, Korçës, Lezhës, Shkodrës, Vlorës dhe Himarës të cilat u monitoruan nga gazetarë lokalë si edhe aktivistë të shoqërisë civile.

Metodologjia e ndjekur për implementimin e këtij projekti është e njëjtë me metodologjinë e përdorur gjatë vitit të shkuar. Për secilën nga bashkitë janë përzgjedhur 4 premtime të bëra nga kryebashkiakët aktualë gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet vendore 2023. Këto premtime u monitoruan në bazë të një metodologjie analitike që përfshinte analizën buxhetore, monitorimin e prokurimit publik dhe vëzhgimet në terren. Gjithashtu raporti ka monitoruar edhe programin e transparencës, detyrim ligjor i Bashkive që rrjedh nga legjislacioni i qeverisjes vendore, legjislacioni i konsultimit publik dhe ligji për të drejtën e Informimit. Nga ana tjetër, transparenca dhe konsultimi publik janë të rregulluara nga kuadri ligjor dhe nënligjor i Shqipërisë. Duke qenë se në bazë të legjislacionit vendas, çdo institucion publik duhet

të zbatojë programin e transparencës, projekti ka monitoruar se sa ky program zbatohet nga bashkitë e përfshira në projekt.

Ky raport i rifreskuar synon që të përcjellë të dhëna lidhur me monitorimin e zbatimit të këtyre parashikimeve nga dhjetë bashki të vendit. Duhet theksuar se këtë vit nuk është përfshirë në raport nga viti i kaluar Bashkia e Dibrës, dhe është bërë pjesë e raportit Bashkia Tiranë, edhe për shkak të zhvillimeve në këtë bashki por edhe për faktin se një e treta e banorëve të vendit banon në kryeqytet apo qarkun përreth tij. Monitorimi e ka përfshirë këtë bashki pikërisht për të siguruar transparencë dhe llogaridhenie, gjatë kësaj periudhe. Në raport do të gjeni metodologjinë e përdorur, gjetjet e detajuara të secilës prej bashkive dhe disa rekomandime për përmirësimin sa i përket llogari-dhënies dhe zbatimit të parashikimeve ligjore në lidhje me transparencën.

Ky raport ndahet në tre kapituj. Kapitulli i parë lidhet me indeksin e transparencës. Kapitulli i dytë me mbajtjen e premtimeve nga ana e kryetarëve të bashkive, kapitulli i tretë lidhet me rëndësinë e Fondit Social si mekanizëm për të fuqizuar bashkitë dhe me problematikat që hasen në përthithjen e fondeve.

RAPORTI 2025


1. Transparenca

1.1 METODOLOGJIA

Detyrimet e njësive të vetëqeverisjes vendore që lidhen me procesin e konsultimit publik dhe zbatimin e transparencës janë identifikuar nëpërmjet analizës së kuadrit ligjor përkatës. Organizimi dhe funksionimi i njësive të vetëqeverisjes vendore është i rregulluar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndërsa detyrimet e tyre për procesin e konsultimit publik dhe zbatimin e transparencës rregullohen më tej nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, siguron disiplinë fiskale, politika të qëndrueshme dhe transparente për menaxhimin e fondeve publike, dhe parashikimin realist të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore.

Normativa ligjore përsa i përket transparencës në njësitë e pushtetit vendor është plotësuar më tej me Urdhërin nr. 211, dt. 20.09.2018, të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ku përcaktohet “Programi Model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, duke detajuar më tej detyrimet e organeve të pushtetit vendor për të siguruar transparencë dhe informim të publikut. Nga parashikimet e këtyre tre ligjeve janë gjeneruar edhe 16 indikatorët për të cilat janë monitoruar dhjetë bashkitë e vendit:

- **INDIKATORI 1:** Caktimi dhe publikimi i një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik;
- **INDIKATORI 2:** Konsultimi i buxhetit vjetor të bashkisë;
- **INDIKATORI 3:** Konsultimi i paketës së taksave dhe tarifave vendore;
- **INDIKATORI 4:** Konsultimi i tjetërsimit të pronave të bashkisë;
- **INDIKATORI 5:** Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 6:** Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të Bashkisë ;
- **INDIKATORI 7:** Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 8:** Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 9:** Përcaktimi dhe publikim i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;
- **INDIKATORI 10:** Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të bashkisë;
- **INDIKATORI 11:** Publikimi i strukturës organizative të bashkisë;
- **INDIKATORI 12:** Publikimi i buxhetit vjetor të bashkisë;



- **INDIKATORI 13:** Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak;
- **INDIKATORI 14:** Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak;
- **INDIKATORI 15:** Publikimi i urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë;
- **INDIKATORI 16:** Publikimi në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike i raporteve të zbatimit të buxhetit.

Të dhënat e këtij raporti për monitorimin e 16 indikatorëve janë mbledhur nga gazetarët në terren. Gazetarët zhvilluan paraprakisht takime informuese me ekspertët të cilët punuan me identifikimin e indikatorëve dhe ekspertin ligjor, për t'u informuar dhe për të marrë shpjegimet përkatëse për të gjithë indikatorët, bazën ligjore të tyre dhe mënyrën e monitorimit. Pas këtij procesi informues dhe sqarues me gazetarët, këta të fundit duke pasur informacionin e duhur mbi indikatorët, mbi parashikimet ligjore të detyrimeve të bashkive për realizimin e tyre dhe burimet nga mund të merrnin informacion për secilin prej tyre, kanë analizuar faqet zyrtare të internetit të bashkive dhe kanë monitoruar stendat e njoftimeve publike të bashkive, si një mënyrë tjetër alternative që përdorin bashkitë për komunikimin me qytetarët. Gjithashtu gazetarët kanë ndjekur drejtëpërdrejtë mbledhjet e këshillit bashkiak, fizikisht dhe/ose online sipas rasteve përkatëse. Një burim tjetër i përdorur nga gazetarët për mbledhjen e të dhënave është komunikimi i drejtëpërdrejtë me bashkinë, duke kërkuar informacion.


Për sa i përket bazës ligjore për kapitullin e katërt, specifikisht për indikatorin: *"Publikimi dhe përditësimi i të dhënave mbi projektet e financuara nga fondet vendore dhe kombëtare"*, edhe pse publikimi i projekteve të financuara nga këto fonde nuk është i përmendur drejtëpërdrejt në një nen të veçantë, ky

detyrim rrjedh në mënyrë të tërthortë nga kuadri ligjor ekzistues. *Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"* përcakton transparencën dhe disiplinën fiskale si parime bazë dhe kërkon publikimin e buxheteve dhe raporteve të zbatimit të tyre, duke nënkuptuar se edhe projektet e financuara me këto fonde duhet të jenë të aksesueshme për publikun. Po ashtu, *Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"* detyron publikimin proaktiv të informacionit që lidhet me përdorimin e fondeve publike, ndërsa *Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"* e lidh transparencën me llogaridhënien dhe përfshirjen qytetare. Në këtë linjë, Programi Model i Transparencës për bashkitë (Urdhri nr. 211/2018) kërkon publikimin e buxheteve dhe dokumenteve të tjera financiare.

Monitorimi për këtë indikator do të kalojë në dy faza verifikimi:

- Faza e parë është mbledhja e të dhënave nëpërmjet informacionit që Bashkitë do na vënë në dispozicion nga kërkesat formale të dërguara.
- Faza e dytë është verifikimi ndër-sektorial (kur është e mundur) me insitucione të tjera publike apo me organizata ndërkombëtare të cilat financojnë projekte me Bashkitë.

Përveç monitorimit të gazetarëve, bashkive të monitoruara i është dërguar shkresë zyrtare duke i kërkuar informacionin dhe dokumentacionin përkatës për indikatorët e mësipërm të cilat lidhen me konsultimin e akteve të miratuara dhe njoftimet që duhet të realizohen në kuadër të zhvillimit të konsultimit publik për to. Për të bërë një renditje të bashkive të përfshira në projekt sa i përket transparencës, për secilin nga indikatorët e sipërpërmendur bashkive u është alokuar nga 1 pikë për një total prej 16 pikësh për bashkitë që plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore.



1.2 PARASHIKIMET LIGJORE TË INDIKATORËVE TË MONITORUAR

Indikatorët e monitoruar për dhjetë bashkitë e vendit janë gjeneruar nga parashikimet ligjore përkatëse të cilat rregullojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, procesin e konsultimit publik dhe transparencën. Konkretisht janë Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” rregullon procesin e konsultimit publik, për të siguruar transparencën, gjithëpërfshirjen dhe realizimin në kohë të veprimeve. Ky konsultim publik, për të siguruar përfshirjen në procesin e vendimmarrjes zhvillohet për projektakte si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik.

Parashikimet ligjore të parashikuara në këtë ligj, zbatimi i të cilave janë monitoruar për bashkitë janë konkretisht:

- Caktimi dhe publikimi i një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik,

i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik¹;

- Konsultimi i buxhetit vjetor të bashkisë²
- Konsultimi i paketës së taksave dhe tarifave vendore³
- Konsultimi i tjetërsimit të pronave të bashkisë⁴
- Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁵
- Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁶
- Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁷
- Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë⁸

¹ “Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuara nga ky ligj”, Neni 10, ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

² “Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektndokumente strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik”, Neni 1, ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Detyrimi për këtë këshillim e konsultim buron edhe nga parashikimet e ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht nenet 18 dhe 54 të këtij ligji.

³ Po aty.


⁴ Po aty.

⁵ “Njoftimi për projektaktet që do t’i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrit elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme: a) me postë elektronike; b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues; c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale; ç) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar. 2. Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike”. Neni 1, ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

⁶ Po aty.

⁷ “Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes”, neni 17, ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Përveç parashikimit në këtë ligj, dy indikatorët e fundit janë analizuar edhe në këndvështrimin e zhvillimit të konsultimit publik, ku nëpërmjet mbledhjeve të këshillit bashkiak e komisioneve, bashkia këshillohet me qytetarët.

⁸ Neni 54 i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikon se Këshilli bashkiak zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet. Komisioni si një nga strukturat e këshillit bashkiak ka të njëjtat detyrime kundrejt qytetarëve të njësisë, për më tepër që këshilli bashkiak ka për detyrë këshillimin me bashkësinë për krijimin e këtyre komisioneve sipas parashikimeve të neneve 18 dhe 54/a të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.



Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Parashikimet ligjore të parashikuara në këtë ligj, zbatimi i të cilave janë monitoruar për bashkitë janë konkretisht:

- Përcaktimi dhe publikim i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit⁹
- Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të bashkisë¹⁰
- Publikimi i strukturës organizative të bashkisë¹¹
- Publikimi i buxhetit vjetor të bashkisë¹²
- Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak¹³
- Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak¹⁴
- Publikimi i urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë¹⁵

⁹ “Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit”, Neni 10, ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

¹⁰ “Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik; b) tekstet e plota... të akteve nënligjore; e) të dhëna për buxhetin”, Neni 7, ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.


¹¹ Po aty.

¹² Po aty.

¹³ Po aty. Zbatimi i parashikimeve të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” referohet për detyrimin e publikimit të akteve të këshillit bashkiak drejtëpërdrejtë nga ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në nenin 18. Në këtë nen parashikohet gjithashtu se aktet e këshillit bashkiak publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty.



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

1.3 GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE (INDIKATORËT E TRANSPARENÇËS)

Për secilën nga bashkitë e përzgjedhura janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet për çdo indikator janë listuar si më poshtë:

BASHKIA DURRËS

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinаторit të konsultimit publik	✓
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë.	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinаторit të konsultimit publik	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	✓
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga përgjigja zyrtare e Bashkisë, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	✓
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Sa i përket paketës së taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2024-2025 ato janë konsultuar me publikun njëkohësisht me buxhetin vjetor 2025 të Bashkisë Durrës. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktivitetesh për përmbushjen e këtij detyrimi.	✓
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia iu përgjigj se nuk ka mbajtur konsultime publike, pasi për periudhën Janar 205 - Dhjetor 2025 nuk është bërë asnjë procedurë për tjetërsim të pronave të Bashkisë Durrës.	✓
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	✓
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓




12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✓
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✓
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Durrës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak	✓
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Durrës ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	✓
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Durrës ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	✓
17	Totali i Realizimit		100¹⁶

BASHKIA TIRANË

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Tiranë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Tiranë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinimit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e emailit dhe të dhënat e koordinimit.	✓
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Tiranë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Tiranë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Tiranë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Tiranë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	✓
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Tiranë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	✓


¹⁶ Bashkia Durrës, në momentin e hartimit të draft-raportit kishte përmbushur vetëm 87.5 % të indikatorëve të transparencës. Pas konsultimeve nga afer me stafin e bashkisë; Bashkia plotësoi edhe 2 indikatorët e mbetur të paplotësuar duke arritur nivelin 100 % të transparencës.



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Është konsultuar me publikun paketa e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Tiranë.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nuk ka njoftime të konsultimit publik për tjetërsimin e pronave në Bashkinë Tiranë.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Tiranë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Këshilli Bashkiak, në çdo mbledhje të tij ka bërë njoftimet ku është treguar data dhe ora për çdo mbledhje të zhvilluar në faqen zyrtare të Bashkisë.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Data dhe ora e mbledhjeve të komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak, gjenden në vijim të njoftimit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak, pas rendit të ditës.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Tiranë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak. Këto mbledhje gjenden si video në faqen zyrtare të Bashkisë në Facebook.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Tiranë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike.	Bashkia Tiranë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Tiranë ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit çdo vit.	
17	Totali i Realizimit		81.25%



BASHKIA SHKODËR

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinorit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e emailit dhe të dhënat e koordinorit.	✓
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen e strukturës organizative të bashkisë.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka të publikuar në internet apo stendë njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	✓
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë.	✓
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Shkodër e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore.	✓
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Shkodër nuk ka kryer tjetërsime pronash në vitin 2025 prandaj ky indikator quhet i realizuar.	✓
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✓
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka vendosur në stendë, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✓
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shkodër nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✓
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	✓




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Shkodër ka publikuar raporte mbi zbatimin e buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		100%

BASHKIA SARANDË


Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor 2025.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Sarandë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Sarandë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Sarandë e ka përmbushur këtë detyrim.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Sarandë nuk ka kryer tjetërsime pronash në vitin 2025 prandaj ky indikator quhet i realizuar.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Sarandë ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	



12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Sarandë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✓
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✓
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Sarandë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Sarandë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	✓
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Sarandë ka publikuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2024.	✓
17	Totali i Realizimit		100%

BASHKIA LEZHË


Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik.	✓
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor për vitin 2025.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	✓



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	✓
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Lezhë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi.	✓
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Lezhë i ka konsultuar me qytetarët vendimet për tjetërsimin e pronave të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve janë konstatuar realizime aktiviteteve për përmbushjen e këtij detyrimi.	✓
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	✓
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka vendosur në stendën e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✓
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	✓
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Lezhë e ka realizuar këtë detyrim për të gjithë muajt e vitit 2025	✓
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	✓
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.	✓
17	Totali i Realizimit		100%



BASHKIA KORÇË

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik.	✓
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	✓
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	✓
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Korçë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore, kur është bërë dhe konsultimi i buxhetit.	✓
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Korçë nuk ka kryer tjetërsime pronash prandaj indikatori quhet i realizuar.	✓
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar këtë detyrim. Në website e Bashkisë janë publikuar vendime të Kryetarit të Bashkisë.	✓
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë ka vendosur në faqen e internetit njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✓
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✓
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Korçë ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		100%

BASHKIA FIER


Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinators të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier nuk ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, Bashkia Fier ka realizuar konsultime publike për buxhetin	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, është realizuar konsultimi i paketës së taksave dhe tarifave vendore.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Fier nuk ka ndjekur procedura për tjetërsimin e pronave përgjatë vitit 2025. Prandaj ky indikator quhet i realizuar.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Fier nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier ka njoftuar paraprakisht në faqen e saj në internet lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	



12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier ka njoftuar paraprakisht në faqen e saj ne internet lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Fier ka publikuar në faqen e internetit raportin e monitorimit të buxhetit për VIII mujorin e vitit 2025.	
17	Totali i Realizimit		81.25%

BASHKIA KAVAJË


Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Kavajë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinatorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Kavajë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Kavajë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kavajë ka publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për paketën e taksave dhe tarifave vendore.	
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Kavajë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kavajë ka vendosur në faqen e internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kavajë ka vendosur në faqen e internetit njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Kavajë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Kavajë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kavajë nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Kavajë ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		75%



BASHKIA VLORË

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinators të konsultimit publik.	✓
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	✓
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor përgjatë viteve.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	✓
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	✓
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Vlorë e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore ashtu si edhe buxhetin.	✓
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka konsultuar me qytetarët vendimin për tjetërsimin e pronave.	✓
10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Vlorë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	✗
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë ka të publikuar njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✓
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✓
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✓
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë nuk ka vendosur në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Vlorë e ka publikuar raportin e për monitorimin për zbatimin e buxhetit vetëm për Periudhën Janar – Prill 2025.	
17	Totali i Realizimit		81.25%


BASHKIA ELBASAN

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	
2	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin e të dhënave të koordinitorit të konsultimit publik.	
3	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	
4	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	
5	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor për vitin 2025.	
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik.	
7	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor të Bashkisë.	
8	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Elbasan e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve ky detyrim del i përmbushur.	
9	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktivitesh për përmbushjen e këtij detyrimi. Bashkia Elbasan iu përgjigj kërkesës së Faktojës, së gjatë këtij viti nuk ka kryer procesin e tjetërsimit të pronës	



10	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Elbasan nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	
11	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan ka vendosur në faqen zyrtare të internetit njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	
12	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	
13	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	
14	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	
15	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjësive publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan ka vendosur faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjësive publike nga këshilli bashkiak.	
16	A janë publikuar në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike raporte të zbatimit të buxhetit?	Bashkia Elbasan ka publikuar raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit.	
17	Totali i Realizimit		93.75%¹⁷

¹⁷ Bashkia Elbasan, në momentin e hartimit të draft-raportit kishte përmbushur vetëm 81.25 % të indikatorëve të transparencës. Pas konsultimeve nga afer me stafin e bashkisë; Bashkia plotësoi edhe 2 indikatorët të tjerë të paplotësuar duke arritur nivelin 93.75 % të transparencës.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

1.4 ANALIZË KRAHASUESE

Në tabelën më poshtë janë përmbledhur rezultatet e monitorimit për të dhjetë bashkitë e monitoruara, të renditura sipas rezultatit në indeksin e transparencës. Vlen të theksohet se për bashkitë Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë, Elbasan, Fier, Sarandë, Durrës dhe Kavajë të cilat u monitoruan dhe vitin e kaluar, Bashkitë Shkodër, Lezhë dhe Vlorë ruajnë të njëjtin nivel transparence si vitin e kaluar, dy tëparat duke plotësuar 100% të indikatorëve kurse e dyta 13 nga 16. Ndërkohë të gjitha bashkitë e tjera; Bashkia Korçë, Sarandë, Fier, Kavajë, Elbasan dhe Durrës shënojnë rritje.

Tre vendet e para me nivelin më të lartë të transparencës, e mbajnë Bashkitë Shkodër, Korçë, Lezhë Sarandë dhe Durrës. Më pas në renditje gjendet Bashkia Elbasan me një nivel transparence prej 93.75% duke realizuar 15 nga 16 indikatorët e matur. Më pas në radhitje gjenden Bashkitë Vlorë, Tiranë, Fier dhe Elbasan duke përmbushur respektivisht 13 nga 16 indikatorë,. E fundit, por me një rritje të ndjeshme nga viti i kaluar gjendet Bashkia Kavajë.

Sa u përket indikatorëve, vërehet se pothuajse të gjitha bashkitë e monitoruara e kanë publikuar Programin e Transparencës në faqen e tyre të


internetit, pa përjashtim. Ndërkohë, 9 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë caktuar dhe publikuar të dhënat për Koordinatorin për Konsultimin Publik, ndërsa për sa i përket të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, të gjitha bashkitë e kanë publikuar në faqet e tyre të internetit.

Bashkitë kanë një performancë relativisht të mirë në konsultimin publik të Buxhetit Vjetor dhe në publikimin e tij në faqen e internetit. Në këtë mënyrë, 9 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë realizuar konsultime publike për hartimin e buxhetit dhe po aq e kanë publikuar buxhetin vjetor. Ndërkohë të gjitha bashkitë e monitoruara kanë zhvilluar konsultime publike për paketën e taksave dhe tarifave vendore.

Sa i përket transparencës së Këshillit Bashkiak, të gjitha bashkitë e monitoruara kanë njoftuar datën dhe orën e Mbledhjes së Këshillit, Bashkiak. Po ashtu 9 nga 10 bashkitë e monitoruara kanë publikuar Proces-Verbalet e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak por nga ana tjetër, të gjitha bashkitë e monitoruara kanë publikuar Vendimet e Këshillit Bashkiak.

Transparenca mbetet relativisht e ulët sa i përket publikimit të Vendimeve dhe Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë. Vetëm 5 nga 10 bashkitë e monitoruara i kanë publikuar urdhërat apo vendimet e Kryetarit duke patur një rritje shumë të lehtë nga viti i kaluar.

Nr	Bashkia	Indeksi i Transparencës
1	Bashkia Shkodër	100%
2	Bashkia Korçë	100%
3	Bashkia Sarandë	100%
4	Bashkia Lezhë	100%
5	Bashkia Durrës	100%
6	Bashkia Elbasan	93.75%
7	Bashkia Vlorë	81.25%
8	Bashkia Tiranë	81.25%
9	Bashkia Fier	81.25%
10	Bashkia Kavajë	75%



1.5 PUBLIKIMI DHE PËRDITËSIMI I TË DHËNAVE MBI PROJEKTET E FINANCUARA NGA FONDET VENDORE, KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

Duke qenë se ky indikator matet për herë të parë në kuadër të këtij raporti, analiza do të kryhet në mënyrë cilësore dhe të veçuar për secilën bashki. Qasja e zgjedhur synon të ofrojë një pasqyrë sa më të saktë të nivelit të transparencës së secilës njësi vendore në lidhje me këto projekte, pa vendosur një renditje krahasuese ndërmjet bashkive, ndryshe nga sa është ndjekur për indikatorët e tjerë. Kjo metodologji lejon identifikimin e praktikave, boshllëqeve dhe specifikave lokale, duke krijuar një bazë referimi për matjet dhe krahasimet e ardhshme.

Para marrjes dhe analizimit të përgjigjeve zyrtare nga bashkitë, është realizuar një fazë përgatitore që ka përfshirë rishikimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për transparencën dhe informimin publik, analizën paraprake të faqeve zyrtare të bashkive dhe dokumenteve të publikuara online. Po ashtu, është kryer një verifikim fillestar i informacionit publikisht të aksesueshëm për këto projekte, me qëllim krahasimin e tij me të dhënat e ofruara më pas nga vetë bashkitë dhe vlerësimin e koherencës ndërmjet burimeve.

1.5.1 FAZA PËRGATITORE

Faza përgatitore e kërkimit konsistoi në pjesën më të madhe në vrojtimin e faqeve zyrtare të Bashkive në internet. Vrojtimi tregoi se informacioni i disponueshëm publikisht mbi këto projekte është i fragmentuar dhe jo gjithmonë i strukturuar në mënyrë të qartë ndërmjet bashkive. Në shumicën e rasteve, të dhënat e identifikuara online kufizoheshin në njoftime të përgjithshme, materiale informuese sporadike ose përmendje të projekteve në dokumente më të gjera strategjike, pa detaje të qarta mbi objektivat, statusin e zbatimit, buxhetin apo

aktorët e përfshirë. Po ashtu, u vu re se seksionet e transparencës në faqet zyrtare të disa bashkive nuk përditësohen rregullisht ose nuk përmbajnë informacion të dedikuar për këtë kategori projektësh, çka e bën të vështirë gjurmimin dhe verifikimin e të dhënave nga publiku.

Kërkimi paraprak evidentoi gjithashtu dallime të konsiderueshme në mënyrën se si bashkitë e konceptojnë dhe e komunikojnë transparencën: disa njësi vendore publikojnë informacion në mënyrë reaktive dhe të shpërndarë, ndërsa të tjera kanë tentativë për të strukturuar informacionin.

Këto gjetje nënvizuan nevojën për mbledhjen e të dhënave direkte nga vetë bashkitë, përmes një instrumenti të unifikuar, me qëllim plotësimin e boshllëqeve të identifikuara gjatë research-it dhe krijimin e një baze më të besueshme për analizën e këtij indikator.


1.5.2 ANALIZIMI I GJETJEVE

1. Bashkia Durrës

Në faqen zyrtare të Internetit për këtë Bashki shfaqet një seksion "PROJEKTE BE" në të cilin janë listuar 3 projekte të financuara nga Bashkimi Evropian specifikisht:

- Approdi Plus
- Projekti Power: Eventi final "from ports to hubs, from hubs to network"
- Zbulimet e arkeologjisë nënujore në Durrës/ projekti approdi

Publikimet e fundit për këto projekte janë bërë në vitin 2021 dhe 2022, duke nënkuptuar se këto projekte janë finalizuar dhe nuk janë ende në proces. Në këtë seksion është listuar po ashtu një projekt: TERRAIN PROJECT për të cilin Bashkia ka specifikuar më shumë detaje duke përfshirë titullin e projektit, kohëzgjatjen, qëllimin dhe statusin e tij. Ndërkohë



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

që shkresës për informacion të dërguar nga Faktoje.al në lidhje me këtë indikator Bashkia Durrës nuk i ka kthyer përgjigje.

Nga informacioni i disponueshëm rezulton se Bashkia Durrës publikon në faqen zyrtare të internetit vetëm të dhëna të pjesshme për projektet e saj, ku shumica e projekteve të listuara janë të përfunduara dhe pa përditësime të fundit. Mungesa e një përgjigjeje ndaj kërkesës për informacion dhe fakti që vetëm për një projekt jepen detaje të plota tregojnë një nivel të kufizuar transparence dhe përditësimi për këtë indikator.

2. Bashkia Tiranë

Bashkia Tiranë ka po ashtu një seksion të dedikuar vetëm për projekte të financuara nga BE në faqen zyrtare, ashtu siç e ka Bashkia Durrës. Ky nënseksion gjendet nën seksionin “Zëri yt” në faqen kryesore të Bashkisë. Informacionet mbi projektet me financim Evropian shpesh publikohen në faqet e donatorëve (BE Delegation/EEAS, EIB, euprojects.al) ose në njoftime specifike të tenderëve – dhe jo gjithmonë rifreskohen në profilin e projekteve të bashkisë. Një prej projekteve është ai i “Suportit në Transportin e gjelbër të kreqytetit” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Gjermania i cili gjendet lehtësisht i publikuar në faqet e partnerëve, por jo në atë të Bashkisë Tiranë. (https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/european-union-and-germany-support-green-transport-tirana-812-million-euro-investments_en?s=214&utm__) Ka edhe projete të tjera me mbështetje nga instrumente të BE-së apo programet e saj (si IPA, WBIF, etj.), por ato sërish gjenden të raportuara vetëm në faqet e donatorëve apo partnerëve të zbatimit.)

Në përfundim, rezulton se Bashkia Tiranë nuk garanton transparencë të plotë mbi projektet e financuara nga fonde ndërkombëtare, pasi informacioni për këto projekte gjendet kryesisht në faqet e donatorëve dhe partnerëve të zbatimit dhe jo në faqen zyrtare të bashkisë, ndërkohë që, pavarësisht kërkesave të adresuara, Bashkia Tiranë nuk ka dhënë përgjigje as në lidhje me projektet e financuara nga fondet vendore apo kombëtare.

3. Bashkia Shkodër


Faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër ka një seksion të dukshëm dhe të përditësuar “Projekte” dhe po ashtu nënseksionet: “Bashkimi Evropian dhe Projektet”, “Projekte Sociale” dhe “Projekte me partnerët”. Megjithatë, informacionet zyrtare më të detajuara për këto projekte shpesh publikohen në faqet e donatorëve (Delegacioni i BE-së, EU4Municipalities, euprojects.al), jo domosdoshmërisht direkt në faqen e Bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër ka dërguar informacion mbi projektet në përgjigje të kërkesës për informacion, duke i strukturuar ato në mënyrë të qartë në tre seksione: investime me fondet e qeverisë qendrore, investime me fondet e Bashkisë dhe investime me bashkëfinancim. (Detajet mbi projektet janë në Aneksin 1 të këtij dokumenti) Megjithatë, pavarësisht faktit që këto të dhëna janë vënë në dispozicion të Faktoje.al, ato nuk pasqyrohen në mënyrë të sistematizuar dhe të përditësuar në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë, duke nënvizuar nevojën për krijimin dhe mirëmbajtjen e një seksioni të dedikuar për projektet.

4. Bashkia Sarandë

Në faqen zyrtare të Bashkisë Sarandë po ashtu nuk ka një seksion të qartë dhe të përditësuar “Projekte” ashtu si të disa bashki të tjera. apo një listë transparente të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian, Përgjashtimisht, publikimet e njoftimeve të tenderëve dhe thirrjeve publike të projekteve pune shfaqen në seksionet e njoftimeve të faqes. Në faqen zyrtare të Bashkisë Sarandë ka thirrje për tenderë dhe ekspertizë për projekte specifike, duke përfshirë:

- DIVE IN ART – projekt për përvojat digjitale dhe punë për galeritë e artist/muzetë.
- Projektet “CLIMATE” – zbatimet që lidhen me qëndrueshmërinë mjedisore dhe socio-ekonomike ndaj ndryshimeve klimatike, ku ka tenderë për shërbime teknike.



Bashkia Sarandë ka marrë pjesë në projekte me financim të jashtëm, duke përfshirë instrumente të Bashkimit Evropian (p.sh. ReLOaD, mbështetje për menaxhim ujrash të zeza, sisteme mbeturinash) dhe projekte rajonale me asistencë teknike por vihet re se:

- Informacioni mbi këto projekte nuk është i organizuar dhe i dukshëm në një seksion të posaçëm "Projekte BE" në faqen zyrtare të Bashkisë, që e vështirëson transparencën dhe gjurmimin e statusit apo rezultateve të tyre.
- Publikimet zyrtare aktuale në faqen e Bashkisë përqendrohen kryesisht tek njoftimet e tenderëve dhe thirrjeve, pa një listë të qartë të projekteve me financim të huaj.

Në lidhje me kërkesën për informacion mbi këto projekte të dërguar nga stafi i Faktoje, Bashkia Sarandë nuk ka kthyer asnjë përgjigje zyrtare.

5. Bashkia Korçë

Faqja zyrtare e Bashkisë Korçë nuk ka një seksion të dedikuar ku janë listuar qartë projektet me financime të huaja ose ndërkombëtare, përfshirë projektet me fonde të Bashkimit Evropian apo donatorë të tjerë. Ekziston një seksion si "Partneritete-Projekte", por ato përmbajnë kryesisht dokumente të vendimmarrjes dhe jo një listë të projekteve të financuara nga donatorë ndërkombëtarë apo Bashkimi Evropian.

Ndërkohë nga kërkimi paraprak ka disa projekte në të cilat Bashkia Korçë është përfshirë me *financim ndërkombëtar apo instrumente të Bashkimit Evropian apo partnerë të tjerë si psh:

- Regional Art Colony in Korçë – projekt kulturor i mbështetur nga Western Balkans Fund, i bashkëfinancuar nga BE përmes IPA III (Instrumenti për Asistencë para-anëtarësimi).
- Pjesëmarrja në grantet e programit EU4LMI – Bashkia Korçë, përmes mbështetjes së BE dhe UNDP, ishte vendtakim ceremonie për grantet

BE për 12 organizata shoqërie civile që shërbejnë edhe qytetarë të Korçës.


Megjithëse Bashkia Korçë nuk ofron në faqen zyrtare të saj një seksion të qartë, të strukturuar dhe të përditësuar për projektet e realizuara dhe financuesit e tyre, përgjigjes me shkrim të Faktoje.al për informacione mbi projektet i është përgjigjur për secilën njësi administrative të sajën (Detajet janë në Aneksin 2 të këtij dokumenti). Lista e projekteve përmban vetëm titullin e tyre, statusin dhe financuesin në rast se bëhet fjalë për projekte me financim të brendshëm apo nga qeveria, por pa specifikime në rastin e donatorëve të huaj.

6. Bashkia Fier

Faqja zyrtare e Bashkisë Fier nuk ka një seksion të dukshëm dhe të përditësuar të projekteve të financuara. Seksionet e dukshme në web (p.sh. Projekt-vendimet dhe Thirrje publike për projekt-propozime) përqendrohen kryesisht tek projekt-vendimet e Këshillit Bashkiak dhe njoftimet për iniciativa të brendshme (si thirrje për organizimin e eventeve kulturore), por nuk paraqesin një listë të qartë të projekteve apo statuset e tyre.

Bashkia Fier ka dërguar përgjigjen e saj në kërkesën për informacion që Faktoje.al i ka dërguar duke listuar 5 projekte, 2 prej të cilëve të përfunduar dhe 3 të tjerë në proces. (Lista e detajuar në Aneksin 3 të këtij dokumenti) Në informacion mungon specifikimi i donatorëve ashtu si edhe shuma e investimit për çdo projekt.

Në përgjigjen e saj Bashkia Fier thekson që të gjithë projektet gjenden të publikuar në faqen zyrtare në internet por nga verifikimi rezulton se vetëm një prej tyre "European Blue Economy Network for Sustainable Innovation (BLUNEW)" është publikuar në seksionin "Lajme". (<https://bashkiafier.gov.al/bashkia-fier-partnere-e-projektit-europian-blue-economy-network-for-sustainable-innovation-blunew/>)



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

7. Bashkia Kavajë

Faqja zyrtare e Bashkisë Kavajë ka një seksion të dedikuar të quajtur "Këndi i BE" në të cilin gjendet një nënseksion "Ide dhe Projekte" dhe të strukturuar të projekteve me financime ndërkombëtare apo sipas burimeve të fondeve.

Në këtë nënseksion ka detaje për projektin: "Vlerat natyrore kulturore lokale për turizëm të qëndrueshëm" në Bashkinë Kavajë, i financuar nga Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2), i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNDP".

Ky është i vetmi projekt i listuar i cili edhe pse duket qartë i strukturuar duke përfshirë:

- Burimin e Financimit
- Qëllimin e përgjithshëm
- Target grupin që preket
- Periudhën e zbatimit

Përsëri mbetet shumë i vjetër pasi periudha e zbatimit të tij ka përfunduar në vitin 2022. Për sa i përket informacioneve të mëtejshme nga Bashkia Kavajë në lidhje me detaje për projektet në zbatim nuk ka ende asnjë përgjigje zyrtare.

8. Bashkia Vlorë

Bashkia Vlorë nuk ka një seksion të qartë, të strukturuar dhe të përditësuar në faqen zyrtare të saj për projektet me fonde ndërkombëtare apo kombëtare, duke bërë që qytetarët të mos kenë një pamje të qartë të projekteve dhe burimeve të tyre të financimit. Megjithatë, ekzistojnë gjurmë të projekteve me mbështetje ndërkombëtare, të evidentuara përmes faqeve të programeve të donatorëve dhe partnerëve të implementimit si EU4Tourism, CITY XCHANGE, programe IPA CBC dhe nisma të tjera ndërkombëtare, të cilat nuk publikohen në mënyrë transparente në faqen e bashkisë. Kjo nënvizon nevojën për një seksion të

dedikuar "Projekte", ku përfshihen edhe projektet ndërkombëtare, i cili të përditësohet rregullisht në webin e Bashkisë.

Bashkia Vlorë ka vënë në dispozicion një listë me 10 projekte me donatorë të huaj (Aneksi 4) për periudhën 2025–2026, ndërkohë që për projektet me financim të brendshëm ka referuar linkun e Buxhetit 2025 në faqen zyrtare të internetit, ku janë publikuar edhe detajet mbi projektet në proces të bashkisë. Megjithatë, për të garantuar transparencë të plotë dhe akses më të lehtë për publikun, këto informacione do të duhej të pasqyroheshin edhe në një seksion të dedikuar dhe të përditësuar rregullisht në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Vlorë.


9. Bashkia Elbasan

Bashkia Elbasan ka një seksion të projekteve të publikueshme në faqen e saj zyrtare, ku paraqitet lista e projekteve të fituara nga donatorë dhe partnerë të jashtëm (të organizuar sipas viteve dhe kategorive).

Në seksionin "Projektet e fituara tek donatorët 2022-2024" mund të shihen emrat e projekteve dhe përshkrimet e tyre (p.sh. për integrim social-ekonomik, qendra karriere, promovim të rinisë, integrimin e grupeve të marginalizuara, promovim turizmi, instalim panele diellore, etj.). Ky seksion është i aksesueshëm publikisht në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan nën kategorinë "Projekte". (<https://elbasani.gov.al/bashkia/projekte/>)

Ky seksion përfshin kryesisht projektet e financuara nga donatorë të jashtëm dhe bashkëfinancime të ndryshme dhe funksionon si një bankë e projekteve të zbatueshme apo të përfunduara, me mundësi për të klikuar për më shumë detaje në listën e tabelave.

Në të kundërt, faqja nuk ka një seksion të veçantë ku shfaqen projektet me financim të brendshëm (nga buxheti i bashkisë) në mënyrë të strukturuar përmes një liste të dedikuar, përtej referencave në vendime të Këshillit ose dokumentet buxhetore.



10. Bashkia Lezhë


Në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë, gjendet seksioni “Projekte” i cili përmban një listë të detajuar me projekte nga donatorë të huaj. Kjo qasje siguron transparencë të plotë dhe akses të qartë për publikun, duke lehtësuar ndjekjen dhe vlerësimin e projekteve nga qytetarët dhe donatorët. Lista e projekteve të publikuar përputhet edhe me ato të listuar në përgjigjen zyrtare të Bashkisë Lezhë dhe po ashtu

me kërkimet paraprake. Kështu për sa i përket projekteve me financim ndërkombëtar Bashkia Lezhë është një nga Bashkitë më transparente.

Megjithëse në faqen zyrtare në internet nuk ka një seksion të dedikuar projekteve me fonde vendore ose kombëtare, Bashkia Lezhë në përgjigjen zyrtare të saj ka listuar të gjithë këto projekte duke nënvizuar se detaje mbi to gjenden në website në seksionin e Buxhetit vjetor 2025 dhe PBA 2025 – 2027.

1.5.3 REKOMANDIME/PËRFUNDIME

Bashkia	Përfundim	Rekomandim
Durrës	Bashkia Durrës publikon informacion të pjesshëm dhe të vjetëruar për projektet, me mungesë përgjigjeje ndaj kërkesës për informacion.	Të përditësojë rregullisht seksionin e projekteve.
Tiranë	Bashkia Tiranë nuk ka transparencë të drejtpërdrejtë, pasi projektet me financim ndërkombëtar publikohen kryesisht në faqet e donatorëve.	Të krijojë një seksion të dedikuar për projektet e financuara dhe t'i pasqyrojë ato sistematikisht në faqen zyrtare.
Shkodër	Bashkia Shkodër ofron informacion të strukturuar vetëm përmes përgjigjeve zyrtare, por jo në faqen e saj të internetit.	Të publikojë në web një seksion të përditësuar për projektet, duke reflektuar të dhënat që tashmë i disponon.
Sarandë	Bashkia Sarandë nuk ka një pasqyrë të qartë dhe të organizuar të projekteve dhe nuk ka kthyer përgjigje zyrtare për informacion.	Të krijojë një seksion transparent për projektet dhe të përmirësojë komunikimin institucional me publikun.
Korçë	Bashkia Korçë nuk pasqyron qartë projektet me financim të huaj në web, pavarësisht pjesëmarrjes në disa iniciativa ndërkombëtare.	Të strukturojë dhe publikojë një listë të plotë projektesh me specifikim të donatorëve dhe statusit të tyre.
Fier	Bashkia Fier ka ofruar informacion të pjesshëm mbi projektet, pa detaje mbi financimin dhe pa pasqyrim të plotë në web.	Të publikojë online listën e projekteve me të dhëna të plota mbi donatorët, buxhetin dhe statusin.
Kavajë	Bashkia Kavajë ka një seksion të strukturuar, por me informacion të kufizuar dhe projekte të vjetëruara.	Të përditësojë seksionin ekzistues me projekte aktive dhe informacion të ri mbi financimet.
Vlorë	Bashkia Vlorë disponon lista projektesh, por nuk i ka të integruara në një seksion të qartë dhe të aksesueshëm në web.	Të krijojë një seksion të dedikuar “Projekte” që të përmbledhë të gjitha financimet vendore dhe ndërkombëtare.
Elbasan	Bashkia Elbasan shfaq nivel të mirë transparence për projektet me donatorë, por jo për ato me financim të brendshëm.	Të zgjerojë seksionin e projekteve duke përfshirë edhe investimet nga buxheti i bashkisë.
Lezhë	Bashkia Lezhë ofron transparencë të lartë për projektet me financim ndërkombëtar dhe informacion të plotë për publikun.	Të konsolidojë më tej transparencën duke krijuar një seksion të dedikuar edhe për projektet me fonde vendore.



2. Monitorimi i Premtimeve

Ekipi i Faktoje përzgjodhi katër premtime të bëra gjatë fushatës elektorale në zgjedhjet vendore Maj 2023 për secilën Bashki, si dhe premtime që lidhen me procesin e rindërtimit për bashki të prekura nga tërmeti i viti 2019. Për monitorimin e këtyre premtimeve është ndjekur metodologjia e mëposhtme:

METODOLOGJIA

Premtimet për shërbimet publike mund të ndahen në dy grupe të mëdha:

- 1 Premtimet që lidhen me aktet administrative mbi uljen apo heqjen e taksave e tarifave apo për kthimin e një hapësire publike në pedonale, apo për hapjen e një qendre sociale, kinemaje, etj.

Mbajtja e këtyre premtimeve realizohet përmes miratimit të akteve administrative ligjore si Vendimet dhe Urdhërat e Kryetarit të Bashkisë dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak. Disa prej këtyre premtimeve kanë edhe efekte financiare dhe për këtë duhet analizuar edhe buxheti për të parë nëse janë parashikuar fonde për ngritjen e një strukture të re;

- 2 Premtimet që lidhen kryesisht me infrastrukturën publike që përbëjnë detyrat dhe kompetencat kryesore të bashkive si ujësjellësi dhe kanalizimet, rrugët dhe hapësirat e gjelbërta, shkollat dhe kopshtet, qendrat shëndetësore, qendrat sociale dhe godinat e tjera publike, etj. Mbajtja e këtyre premtimeve lidhet ngushtësisht me buxhetin e bashkive.


Për të analizuar dhe dokumentuar mbajtjen e këtyre premtimeve fillimisht duhet parë nëse ato janë përfshirë në buxhetin e Bashkisë, më saktësisht në “Shpenzimet Kapitale” apo në

“Shpenzimet e Mirëmbajtjes”. Megjithatë, edhe nëse janë përfshirë në buxhet, nuk do të thotë se premtimet do të mbahen pasi bashkitë pothuajse gjithmonë nuk i përmbahen angazhimeve të buxhetit. Prandaj është me rëndësi që të shihet edhe nëse një bashki ka bërë ose planifikon të bëjë prokurimin publik për projektin në fjalë. Plani i prokurimeve mund të shihet në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Vlen të theksohet se realizimi i disa prej këtyre premtimeve mund të bëhen edhe në bashkëpunim apo me ndihmën e instituioneve të tjera, si Ministrinë e Linjës, psh, Ministria e Shëndetësisë për qendrat shëndetësore apo AKUM për ujësjellësat apo landfillet. Prandaj është e rëndësishme që të studiohen edhe buxhetet dhe prokurimet e këtyre instituioneve për të parë nëse e kanë përfshirë këtë projekt apo jo. Si rrethim, në bazën e të dhënave parashikohet të ekzistojë edhe seksioni “Institucion tjetër i përfshirë” për të identifikuar dhe monitoruar edhe këto institucione që mund të financojnë plotësisht apo bashkë-financojnë me bashkitë implementimin e këtyre projekteve.

Indikatorët që propozohet të maten, sa u takon Shërbimeve Publike, janë:

- 1 Vendimet dhe Urdhërat e Kryetarit të Bashkisë;
- 2 Vendimet e Këshillit Bashkiak;
- 3 Buxheti;
- 4 Plani i Prokurimeve;
- 5 Lista e Kontratave të Shpallura;
- 6 Buxheti i Institucioneve të tjera të Përfshira dhe plani i tyre i prokurimeve.



Për monitorimin e realizimit të këtyre premtimeve, Ekipi i Faktoje ndërmorri hapat e mëposhtme:

- 1 Analiza e buxhetit të bashkive;
- 2 Analiza e Planit të Prokurimeve;
- 3 Dërgimi i kërkesave për informacion pranë bashkive;
- 4 Realizimi i vizitave në terren për të parë gjendjen nga afër.

2.1 PREMTIMET E MONITORUARA

Premtimet e përzgjedhura për secilën nga Bashkitë e përfshira në projekt janë si më poshtë.

Bashkia Durrës

- ◆ Rindërtimi i pallateve DS5 të lagjes nr. 5 në të njëjtin vend.
- ◆ Ndërtimi i një godine parkimi publik në qendër të qytetit.
- ◆ Ndërtimi i Parkut Urban në Spitallë
- ◆ Rikonstruksioni i 'Pallatit të Sportit'

Bashkia Tiranë

- ◆ Ndërtimi i tre shkollave të reja për zonën e Astirit dhe Yzberishtit.
- ◆ Furnizimi me ujë i Tiranës në 100% të territorit të saj.
- ◆ Projekti për drekë falas në shkollat 9 vjeçare të Tiranës.
- ◆ Lirimi i të gjitha hapësirave publike në kryeqytet

Bashkia Shkodër

- ◆ Dublimi i Urës së Bahçallëkut dhe zgjerimin e rrugës deri tek Harku i Bërdicës.
- ◆ Rikonstruksioni i plotë të shkollës 9-vjeçare "Ndre Mjeda".
- ◆ Ndërtimi i muzeut të lundrimit në hyrje të qytetit.
- ◆ Përfundimi i rrugës Shirokë – Zogaj – Kufi.

Bashkia Sarandë

- ◆ Ndërtimi i një terminali model për autobusat interurbanë në hyrje të Sarandës.
- ◆ Rehabilitimi i rrugës "Gjashtë"
- ◆ Ndërtimi i 4 parkingjeve publike që lehtësojnë qëndrimin e turistëve në qytet.
- ◆ Rehabilitimi i rrugëve të brendshme në qytet

Bashkia Lezhë

- ◆ Investime në ndriçimin rural në Ishull Shëngjergj
- ◆ Garantimi i energjisë elektrike në fshatin Gjadër.
- ◆ Rimbursimi i biletës së transportit urban në Lezhë.
- ◆ Rindërtimi i pallatit 71 në rrugën 'Luigj Gurakuqi' në lagjen 'Besëlidhja'

Bashkia Korçë


- ◆ Ndërtimi i një resorti skish në një nga zonat më të bukura malore të Korçës.
- ◆ Ndërtimi i Aeroportit të Korçës.
- ◆ Investime në rrugën drejt Teqesë së Melçanit.
- ◆ Projekti i gazifikimit të Korçës.

Bashkia Fier

- ◆ Ndërtimi i një tregu bashkëkohor për tregtimin me shumicë të produkteve bujqësore.
- ◆ Rehabilitimi i lumit Gjanica dhe ndërtimi i shëtitorës përkrah tij.
- ◆ Rehabilitimi i qendrës së Libofshës
- ◆ Rehabilitimi i rrugëve dhe kanaleve kulluese në njësinë administrative Levan.

Bashkia Kavajë

- ◆ Ofrimi i bonuseve mujore në vlerën 5 mijë lekë në muaj për çdo lindje të re në Bashkinë Kavajë në vitin e parë të jetës"
- ◆ Zgjidhja përfundimtare e çështjes së ujit duke mundësuar furnizim 24 orë me ujë të pijshëm fshatrat Rrakull dhe Karpen
- ◆ "Ndërtimi i Rrugës së Bregdetit"
- ◆ Pastrimi i qytetit të Kavajës



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

Bashkia Vlorë

- ◆ Ndërtimi i terminalit të autobusave në Vlorë.
- ◆ Krijimi i qendrës ditore për moshën e tretë në secilin rajon të qytetit si dhe ngritjen e një mense sociale bashkiake për shtresat në nevojë.
- ◆ Zgjidhje përfundimtare e furnizimit me ujë të pijshëm.
- ◆ Pastrimi i qytetit dhe zgjidhja e çështjeve të mbetjeve.

Bashkia Elbasan

- ◆ Rregullimi i pjesës së parë të rrugës ekzistuese drejt fshatit Funar.
- ◆ Pastrimi i përroit të Gurrës.
- ◆ Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare 'Jonuz Çarçiu' në fshatin Tregan dhe rikonstruksionin e shkollës 'Naim Frashëri' në qytetin e Elbasanit
- ◆ Ndërtimi i pikave të grumbullimit të prodhimit bujqësor në Shushicë, Bradashesh, dhe Gjergjan.

PROJEKTET E MËDHA

Projektet e mëdha përfshijnë projekte që kërkojnë një financim shumë të madh krahasuar me buxhetin e një bashkie e kërkojnë domosdoshmërisht përfshirjen dhe financimet e Qeverisë Qëndrore. Në

këto projekte përfshihen Autostradat dhe Rrugët Kombëtare, Portet, Aeroportet dhe Terminale, Spitalet, Teatrot, Stadiumet, etj.


Këto projekte, pavarësisht se mund të jenë premtuar nga Kryebashkiakët, faktikisht janë jashtë kompetencave të Bashkisë. Por, premtimi i kryetarëve mund të lidhet edhe me lobimin pranë Qeverisë apo Ministrive për financimin e këtyre projekteve. Prandaj, për monitorimin e realizimit të këtyre premtimeve duhet të monitorohet buxheti dhe plani i prokurimeve i institucionit qendror e jo i bashkisë.

Indikatorët që propozohet të maten, sa u takon Projekteve të Mëdha, janë:

- ◆ Buxheti i Institucioneve qendrore në varësi të fushës, si psh. Ministrisë së Shëndetësisë për Spitalet, FSHF/MASR për Stadiumet, FSHZH apo ARRSH për rrugët, etj.

Për monitorimin e realizimit të këtyre premtimeve, Ekipi i Faktoje ndërmorri hapat e mëposhtme:

- ◆ Analiza e buxhetit të bashkive;
- ◆ Analiza e Planit të Prokurimeve;
- ◆ Dërgimi i kërkesave për informacion pranë bashkive;
- ◆ Realizimi i vizitave në terren për të parë gjendjen nga afër.



2.2 GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE (PREMTIMET)

BASHKIA DURRËS


Premtimi	Komente	Statusi
Rindërtimi i pallateve DS5 të lagjes nr. 5 në të njëjtin vend.	Në këtë zonë ka përfunduar vetëm një pallat, ku sipas Bashkisë janë strehuar 29 familje ndërkohë që ende nuk ka nisur puna për rindërtimin e 8 të tjerëve.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i një godine parkimi publik në qendër të qytetit.	Godina e parkimit publik në qendër të qytetit të Durrësit është hapur përfundimisht, megjithëse me tejkalimin e afateve.	Premtim i mbajtur
Ndërtimi i Parkut Urban në Spitalë	Edhe pse punimet kanë avancuar ndjeshëm, Parku Urban ende nuk është përfunduar, megjithëse kanë kaluar 12 muaj nga nisja e zbatimit	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rikonstruksioni i 'Pallatit të Sportit'	Rikonstruksioni i Pallatit të Sportit "Ramazan Njala" nuk ka nisur ende.	Premtim i pambajtur

BASHKIA LEZHË

Premtimi	Komente	Statusi
Investime në ndriçimin rural në Ishull Shëngjergj	Financimi për ndriçimin publik në Ishull Shëngjin është siguruar nga fondet e FSHZH-së dhe programi PROLIGHT Med, ndërsa procedura e prokurimit është mbyllur dhe pritët faza e vlerësimit e lidhjes së kontratës.	Premtim i mbajtur
Garantimi i energjisë elektrike në fshatin Gjadër.	Takimet me banorët në terren tregojnë se ata kanë ende probleme të theksuara me elektricitetin, ndërkohë Bashkia në përgjigjen e saj thotë se kjo çështje nuk është pjesë e kompetencave të saj.	Premtim i pambajtur
Rimbursimi i biletës së transportit urban në Lezhë.	Bashkia bën me dije se ka filluar zbatimin e projektit SMART LAND 2, ku do të blihet një automjet transporti publik për nevojat të moshës së tretë, ku do të përfshihet edhe rimbursimi i biletës së transportit. Gjithashtu masa për rimbursimin e biletës do të parashikohet edhe në Planin e Transportit i cili do të hartohet gjatë vitit 2026.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rindërtimi i pallatit 71 në rrugën 'Luigj Gurakuqi' në lagjen 'Besëlidhja'	Në përgjigjen zyrtare të saj Bashkia bën të ditur se ka përfunduar procedura e vlerësimit, është lidhur kontrata dhe pritët marrja e lejes së ndërtimit. Sapo të mbyllet kjo procedurë sipas afateve ligjore do të fillojë edhe puna për rindërtimin e këtij pallati.	Premtim i mbajtur

BASHKIA SHKODËR

Premtimi	Komente	Statusi
Dublimi i Urës së Bahçallëkut dhe zgjerimin e rrugës deri tek Harku i Bërdicës.	Vërejtjet në terren treguan se puna po vijon në tre segmente paralelisht. Deri më tani janë përfunduar 4 nga 5 pilotat e planifikuara, ndërsa rruga nga Harku i Bërdicës parashikohet të përfundojë në fillim të vitit të ardhshëm.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rikonstruksioni i plotë të shkollës 9-vjeçare "Ndre Mjeda"	Vëzhgimi në terren tregoi se nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Ndre Mjeda" e nisën vitin shkollor në një godinë të rikonstruktuar tërësisht.	Premtim i mbajtur
Ndërtimi i muzeut të lundrimit në hyrje të qytetit.	Nga vizita në terren ekipi i Faktoje hasi në dhjetëra punonjës që po i jepnin formën e parë 'Muzeut të Lundrimit'	Premtim pjesërisht i mbajtur
Përfundimi i rrugës Shirokë – Zogaj – Kufi.	Nga verifikimet e fundit, segmenti i bypass-it që kalon në fshatin Zogaj kishte përfunduar hapjen e trasesë, ndërsa po vijonte puna për mbushjen dhe shtresat përfundimtare të rrugës.	Premtim pjesërisht i mbajtur



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA SARANDË


Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i një terminali model për autobusat interurbanë në hyrje të Sarandës.	Edhe pse afatet e përfundimit të punimeve ishin 14 muaj nga nisja, tashmë pas 22 muajve terminali jo vetëm nuk ka përfunduar, por dukshëm ka ende nevojë për punime.	Premtim i pambajtur
Rehabilitimi i rrugës "Gjashtë"	Për nisjen e punimeve në këtë rrugë u la afat maksimal deri në muajin tetor, por punimet ende nuk kanë nisur. Premtimi për nisjen e punimeve të Rrugës së Gjashtë në Sarandë konsiderohet i pambajtur	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i 4 parkingjeve publike që lehtësojnë qëndrimin e turistëve në qytet.	Nga verifikimi në terren, dy vite pas premtimit, në Sarandë parkimi është një mision gati i pamundur.	Premtim i pambajtur
Rehabilitimi i rrugëve të brendshme në qytet	Ndonëse disa rrugë të brendshme në qytetin e Sarandës janë të shtruara dhe sistemuara, premtimin se në sezonin turistik nuk do kishte asnjë rrugë të pambaruar në Sarandë dhe Ksamil do e konsiderojmë të pambajtur.	Premtim i pambajtur

BASHKIA TIRANË

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i tre shkollave të reja për zonën e Astirit dhe Yzberishtit.	Ndërtimi i tre shkollave në lagjet Yzberisht dhe Astir në Tiranë, nisur edhe nga verifikimi në terren nuk është përfunduar ende.	Premtim i pambajtur
Furnizimi me ujë i Tiranës në 100% të territorit të saj.	Tirana vijon të përballët me mungesën e ujit të pijshëm në disa zona të saj, veçanërisht në njësitë 1 dhe 2, kryesisht përgjatë muajve të verës. Pavarësisht investimeve të kryera në përmirësimin e rrjetit shpërndarës dhe në impiantin e Bovillës, kryeqyteti vijon të mos furnizohet rregullisht me ujë të pijshëm.	Premtim i pambajtur
Projekti për drekë falas në shkollat 9 vjeçare të Tiranës.	Nga përgjigjja zyrtare e Bashkisë Tiranë "Nisma 'Ushqimi në shkollë' është në fazën e diskutimit me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit" pa specifikuar se kur mund të bëhet realitet.	Premtim i pambajtur
Lirimi i të gjitha hapësirave publike në kryeqytet	Nga vëzhgimi në terren në kryeqytet ka ende hapësira publike të zëna nga subjekte private	Premtim pjesërisht i mbajtur

BASHKIA KORÇË

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i një resorti skish në një nga zonat më të bukura malore të Korçës.	Premtimi ka kaluar nga një fazë në tjetrën pa asnjë hap konkret. Ndërkohë në një përgjigje zyrtare, Bashkia Korçë thotë se nuk ka asnjë informacion për këtë projekt.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i Aeroportit të Korçës.	Edhe pse Bashkia e Korçës e konsideron projektin fizikisht të përfunduar, krahasimi me video 3D tregon qartë se realiteti është shumë larg vizionit të fushatës.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Investime në rrugën drejt Teqesë së Melçanit.	Faktoje verifikoi në terren investimin në këtë segment. Rruga ishte e përfunduar, e shtruar dhe funksionale duke lidhur fshatin Melçan me Teqenë "Baba Abdulla".	Premtim i mbajtur
Projekti i gazifikimit të Korçës.	Përgjigjja zyrtare nga Bashkia Korçë tregon se projekti ndodhet ende në fazën e parafizibilitetit.	Premtim i pambajtur




BASHKIA FIER

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i një tregu bashkëkohor për tregtimin me shumicë të produkteve bujqësore.	Nisur nga mungesa e punimeve, deklaratat zyrtare dhe situata e verifikuar në terren këtë premtim e konsiderojmë të pambajtur.	Premtim i pambajtur
Rehabilitimi i lumit Gjanica dhe ndërtimi i shëtitores përkrah tij.	Duke marrë parasysh që punimet janë ende në zhvillim dhe përfundimi i projektit pritet pas rreth 8 muajsh, premtimi për vijimin e punimeve të lumit Gjanica kategorizohet si pjesërisht i mbajtur.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rehabilitimi i qendrës së Libofshës	Nga verifikimet në terren rezulton se në zonë janë ende makina të punimeve dhe disa hapësira të pa sistemuara, duke treguar se puna nuk ka përfunduar plotësisht.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rehabilitimi i rrugëve dhe kanaleve kulluese në njësinë administrative Levan.	Nga krahasimi i të dhënave zyrtare me gjendjen reale në terren, "Faktoje" konstaton se premtimi për përfundimin e rehabilitimit të rrugëve dhe pastrimit të kanaleve kulluese në njësinë Levan mbetet pjesërisht i mbajtur.	Premtim pjesërisht i mbajtur

BASHKIA KAVAJË

Premtimi	Komente	Statusi
Ofrimi i bonuseve mujore në vlerën 5 mijë lekë në muaj për çdo lindje të re në Bashkinë Kavajë në vitin e parë të jetës"	Bashkia e Kavajës ende nuk e jep bonusin mujor prej 5 mijë lekësh për bebet e sapolindura, duke theksuar në përgjigjen e saj që nuk ka informacion pasi fondi vjen nga Ministria.	Premtim i pambajtur
Zgjidhja përfundimtare e çështjes së ujit duke mundësuar furnizim 24 orë me ujë të pijshëm fshatrat Rrakull dhe Karpen	Banorët e fshatrave Rrakull dhe Karpen në Kavajë nuk kanë ujë 24 orë. Ujësjetësi i Durrësit nuk ka kthyer ende një përgjigje mbi kërkesën për informacion të dërguar nga stafi i Faktoje.	Premtim i pambajtur
"Ndërtimi i Rrugës së Bregdetit"	Sipas përgjigjes së Bashkisë, punimet për këtë rrugë nuk kanë nisur ende dhe Bashkia është në bashkëbisedim me qeverinë për ndërtimin e kësaj rruge.	Premtim i pambajtur
Pastrimi i qytetit të Kavajës	Nga verifikimi në terren rezulton se koshat pastrohen me rregull, por hapësirat përreth shpesh mbeten jashtë vëmendjes.	Premtim pjesërisht i mbajtur



RAPORT MONITORIMI


TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

BASHKIA VLORË

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i terminalit të autobusave në Vlorë.	Nga verifikimet e Faktoje.al terminali interurban ende nuk ka nisur të ndërtohet. Bashkia thotë se janë ende në bisedime paraprake për të siguruar fondet, por pa lënë një afat se kur mund të hartohet projekti.	Premtim i pambajtur
Krijimi i qendrës ditore për moshën e tretë në secilin rajon të qytetit si dhe ngritjen e një mense sociale bashkiake për shtresat në nevojë.	Bashkia Vlorë pohon se në bazë të planit social 2024-2027 ka aplikuar dhe ka fituar projektin e ngritjes së një qendre të re për të moshuar, por pa specifikuar se kur kjo qendër do të jetë funksionale.	Premtim i pambajtur
Zgjidhje përfundimtare e furnizimit me ujë të pijshëm.	Nga verifikimi në terren i Faktoje.al rezulton që Vlora vijon të ketë probleme me furnizimin normal me ujë të pijshëm. Ende nuk ka një përgjigje nga ana e Bashkisë për këtë çështje.	Premtim i pambajtur
Pastrimi i qytetit dhe zgjidhja e çështjeve të mbetjeve.	Faktoje.al pa nga afër fushën e mbetjeve dhe u konstatua se mbetjet urbane që mbledhen në Vlorë dhe Orikum vijnë në hidhen në këtë fushëdepozitimi mbetjesh edhe pas deklaratës së ish-kryebashkiakut Dredha se ai venddepozitim nuk përdorej më.	Premtim i pambajtur

BASHKIA ELBASAN

Premtimi	Komente	Statusi
Rregullimi i pjesës së parë të rrugës ekzistuese drejt fshatit Funar.	Nga verifikimi në terren në Tetor 2025, Faktoje vëzhgoi se rruga e Funarit ishte shtruar në disa segmente, ndërsa në pjesë të tjera të saj ende nuk ishte vënë dorë.	Premtim i pambajtur
Pastrimi i përroit të Gurrës.	Sipas përgjigjes së Bashkisë Elbasan as në vitin 2024 nuk kishte një projekt rehabilitimi për Gurrën e Shushicës,	Premtim i pambajtur
Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare 'Jonuz Çarçiu' në fshatin Tregan dhe rikonstrukcionin e shkollës 'Naim Frashëri' në qytetin e Elbasanit	Bashkia Elbasan ka hapur dyert e shkollës së re "Jonuz Çarçiu" në Shtator 2025. Ndërkohë që në përgjigjen e saj për shkollën "Naim Frashëri" pohon se kjo shkollë është në proces prokurimi, fakt që u verifikua dhe nga ekipi i Faktoje nga të dhënat në Open Data.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Ndërtimi i pikave të grumbullimit të prodhimit bujqësor në Shushicë, Bradashesh, dhe Gjergjan.	Në Shushicë, Bradashesh dhe Gjergjan nuk ekzistonin pika grumbullimi. Nga verifikimi në terren rezulton se në këto fshatra ende nuk ka anjë pike grumbullimi.	Premtim i pambajtur



Konkluzione

Analiza e premtimeve elektorale në disa prej bashkive kryesore të vendit tregon një panoramë problematike të nivelit të mbajtjes së angazhimeve publike. Në shumicën e rasteve, premtimet ose kanë mbetur të pambajtura, ose janë realizuar vetëm pjesërisht, duke reflektuar një hendek të dukshëm mes retorikës elektorale dhe zbatimit konkret në terren. Nga 40 premtimet e mara në analizë:

- Vetëm 5 nga 40 premtime janë realizuar plotësisht, çka tregon një nivel shumë të ulët përbushjeje.
- 12 premtime ndodhen në një zonë gri, ku punimet kanë nisur ose janë planifikuar, por pa rezultate përfundimtare.
- 23 premtime, pra shumica absolute, rezultojnë tërësisht të pambajtura, pa punime, pa afate ose pa zbatim konkret.


Në tërësi, premtimet e mbajtura plotësisht përbëjnë një përqindje shumë të vogël të totalit. Ato hasen

kryesisht në projekte të kufizuara infrastrukturore, ku ndërhyrjet janë më të lehta për t'u realizuar dhe për t'u verifikuar nga publiku. Ndërkohë, pjesa dërmuese e angazhimeve ose janë zvarritur në kohë, ose nuk kanë kaluar kurrë fazën e deklaratave.

Një nga fushat ku vërehet një nivel relativisht më i lartë realizimi është infrastruktura rrugore. Në disa bashki, rrugë lokale apo segmente lidhëse janë ndërtuar ose janë në proces përfundimi. Megjithatë, edhe në këtë sektor, një numër i madh projektsh rezultojnë të papërfunduara, duke u kategorizuar si "pjesërisht të mbajtura". Kjo tregon se edhe aty ku ka ndërhyrje konkrete, afatet dhe standardet e premtuara shpesh nuk respektohen.

Në fushën e arsimit, situata paraqitet disi më e balancuar. Ka raste ku shkolla janë rikonstruktuar dhe janë vënë në funksion, por këto mbeten përjashtime. Në bashki të mëdha, si Tirana, premtime të rëndësishme për ndërtimin e shkollave të reja ende nuk janë përbushur, duke ndikuar drejtpërdrejt në mbingarkesën e sistemit arsimor urban.

Fusha	Niveli i mbajtjes së premtimeve
Infrastrukturë rrugore	Mesatar
Arsimi	Mesatar
Rindërtimi	I dobët
Transporti publik	Shumë i dobët
Furnizimi me ujë	Shumë i dobët
Mjedisi & pastrimi	I dobët
Politika sociale	Shumë i dobët



3. Fondi Social

RAPORT MONITORIMI MBI ZBATIMIN E FONDIT SOCIAL NË 61 BASHKITË E SHQIPËRISË (2023–2025)

Ky raport paraqet rezultatet e monitorimit trevjeçar (2023–2025) mbi zbatimin e Fondit Social në 61 bashkitë të Republikës së Shqipërisë, me fokus në mënyrën e planifikimit, financimit, zbatimit dhe raportimit të shërbimeve sociale për grupet vulnerabël. Në dallim nga raportet e mëparshme, analiza e këtij viti thekson veçanërisht transparencën institucionale, koherencën e të dhënave ndërmjet institucioneve përgjegjëse, si dhe qëndrueshmërinë reale të shërbimeve përtej periudhës së financimit nga Fondi Social.

Fondi Social përbën një instrument kyç të politikave publike në fushën e mbrojtjes sociale, duke synuar mbështetjen e bashkive për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për kategori të ndryshme në nevojë, përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe familjet vulnerabël, si dhe individët në situata të veçanta risku. Nëpërmjet këtij mekanizmi, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë mundësi të forcojnë infrastrukturën e shërbimeve sociale dhe të adresojnë nevoja konkrete të komuniteteve lokale.

Megjithatë, të dhënat e mbledhura gjatë këtij procesi monitorimi tregojnë se, përveç progresit në zgjerimin e mbulimit të shërbimeve dhe rritjes së numrit të bashkive përfituese, vazhdojnë të ekzistojnë sfida të rëndësishme në lidhje me raportimin e të dhënave, transparencën e përdorimit të fondeve, harmonizimin e informacionit ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe planifikimin afatmesëm për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të shërbimeve.

Raporti bazohet në të dhëna zyrtare të siguruara nga bashkitë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Shërbimi Social Shtetëror


(SHSSH) dhe Ministria e Financave, si dhe në analiza krahasuese të praktikave të raportimit për periudhën 2023–2025. Nëpërmjet kësaj qasjeje, synohet të identifikohen jo vetëm nivelet e financimit dhe shtrirja e shërbimeve, por edhe cilësia e qeverisjes së Fondit Social, shkalla e transparencës dhe efektiviteti i mekanizmave të monitorimit.

Objektivi kryesor i këtij raporti është të kontribuojë në përmirësimin e politikëbërjes në fushën e mbrojtjes sociale, duke ofruar një pasqyrë të bazuar në evidencë mbi funksionimin e Fondit Social dhe duke propozuar rekomandime konkrete për rritjen e transparencës, forcimin e koordinimit institucional dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve sociale në nivel vendor.

METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Ky raport është ndërtuar mbi një proces të strukturuar monitorimi dhe analize, i cili synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të bazuar në evidencë mbi mënyrën se si Fondi Social është planifikuar, financuar dhe zbatuar në 61 bashkitë të Shqipërisë gjatë periudhës 2023–2025. Qasja metodologjike ka kombinuar mbledhjen e të dhënave sasiore me analizën cilësore, me qëllim identifikimin e trendeve, problematikave dhe praktikave institucionale që ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e shërbimeve sociale.

Të dhënat janë siguruar përmes kërkesave zyrtare për informacion drejtuar bashkive, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) dhe Ministrisë së Financave (MF). Informacioni i kërkuar përfshinte vlerat e financimit për Fondin Social për vitet 2023, 2024 dhe 2025, numrin dhe tipologjinë e shërbimeve të ofruara, statusin e Planeve Vendore Sociale, planifikimin buxhetor afatmesëm për vazhdimësinë e



shërbimeve, si dhe kategoritë e përfituesve.

Procesi i mbledhjes së të dhënave u shoqërua me një analizë krahasuese të përgjigjeve të institucioneve të ndryshme, me qëllim verifikimin e koherencës së informacionit dhe identifikimin e mospërputhjeve në raportimet financiare dhe programore. Në disa raste, mungesa e përgjigjeve ose informacioni i pjesshëm nga institucione të caktuara kufizoi mundësinë për një analizë të plotë dhe të harmonizuar, duke reflektuar vetë një nga problematikat kryesore të evidentuara në këtë raport: mungesën e një sistemi të unifikuar raportimi dhe transparence.

Analiza është fokusuar në disa dimensione kryesore: shtrirjen gjeografike të Fondit Social, trendet në numrin e bashkive përfituese dhe shërbimeve të ofruara, qëndrueshmërinë e shërbimeve pas përfundimit të financimit, si dhe prioritetet tematike të ndërhyrjeve sociale, si mbështetja për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe familjet në nevojë, apo viktimat e dhunës.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar gjithashtu nivelit të transparencës publike dhe mënyrës se si institucionet raportojnë për përdorimin e fondeve dhe rezultatet e arritura. Krahasimi i të dhënave ndërmjet MSHMS, SHSSH dhe bashkive ka nxjerrë në pah mospërputhje të përsëritura, të cilat jo vetëm që vështirësojnë monitorimin e efektivitetit të Fondit Social, por edhe kufizojnë mundësinë për vlerësime të sakta mbi ndikimin real të shërbimeve sociale.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, metodologjia e ndjekur ka mundësuar identifikimin e problematikave strukturore, trendeve kryesore dhe boshllëqeve në planifikimin dhe zbatimin e politikave sociale në nivel vendor. Qëllimi kryesor i këtij procesi monitorimi ka qenë jo vetëm dokumentimi i situatës ekzistuese, por edhe ofrimi i një baze të qëndrueshme analitike për përmirësimin e politikëbërjes, forcimin e koordinimit institucional dhe rritjen e llogaridhënies në përdorimin e Fondit Social.


GJETJET KRYESORE, IMPLIKIMET DHE DREJTIMIT PËR PËRMIRËSIM

Analiza e të dhënave të mbledhura për periudhën 2023–2025 tregon se Fondi Social ka luajtur një rol të rëndësishëm në zgjerimin e shtrirjes së shërbimeve sociale dhe në rritjen e numrit të bashkive përfituese. Në shumë territore, ky mekanizëm ka mundësuar krijimin e shërbimeve të reja dhe mbështetjen e grupeve vulnerabël që më parë kishin akses të kufizuar në përkujdesje sociale. Megjithatë, funksionimi i Fondit Social vijon të shoqërohet me sfida të thella strukturore, institucionale dhe operacionale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në transparencën, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve sociale.

Një nga problematikat më të dukshme mbetet mungesa e transparencës publike mbi përdorimin e fondeve. As institucionet qendrore dhe as bashkitë nuk publikojnë në mënyrë të rregullt raporte të detajuara mbi alokimin e financimeve, shërbimet e ofruara dhe rezultatet e arritura. Edhe pse Shërbimi Social Shtetëror deklaron se kryen monitorim të vazhdueshëm të shërbimeve të financuara, këto raporte nuk janë të aksesueshme për publikun. Si rrjedhojë, mundësia për vlerësim të pavarur, kontroll qytetar dhe llogaridhënie institucionale mbetet e kufizuar.

Një tjetër sfidë e përsëritur lidhet me mospërputhjet e të dhënave ndërmjet institucioneve. Krahasimi i informacionit të raportuar nga bashkitë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror tregon diferenca në vlerat financiare, numrin e shërbimeve dhe statusin e projekteve. Kjo situatë reflekton mungesën e një sistemi të unifikuar raportimi dhe dobëson besueshmërinë e të dhënave zyrtare. Mungesa e koordinimit ndërinstitucional e bën të vështirë monitorimin efektiv të Fondit Social dhe pengon analizën e ndikimit real të ndërhyrjeve sociale në komunitet.

Procesi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave mbetet i fragmentuar. Institucionet përdorin formate



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

të ndryshme raportimi, ndërsa informacioni shpesh jepet në mënyrë të pjesshme ose jo të strukturuar. Në disa raste, bashkitë nuk i janë përgjigjur kërkesave për informacion, duke kufizuar ndjeshëm ndërtimin e një pasqyre të plotë dhe të saktë në nivel kombëtar. Ky fragmentarizim i të dhënave e vështirëson analizën krahasuese dhe redukton cilësinë e procesit të monitorimit.

Një gjetje me rëndësi lidhet me qëndrueshmërinë financiare të shërbimeve sociale. Edhe pse për vitin 2025 vihet re një rritje e deklarimeve nga bashkitë për parashikime buxhetore në planet afatmesme, në shumicën e rasteve mungojnë vlerat konkrete dhe angazhimet e qarta financiare. Kjo tregon se planifikimi për vazhdimësinë e shërbimeve mbetet kryesisht deklarativ dhe i pasigurt, duke rritur rrezikun e ndërprerjes së shërbimeve pas përfundimit të financimit nga Fondi Social. Varësia e lartë nga fondet qendrore kufizon autonominë financiare të bashkive dhe dobëson qëndrueshmërinë afatgjatë të ndërhyrjeve sociale.

Në këtë kontekst, forcimi i planifikimit buxhetor në nivel vendor bëhet thelbësor. Bashkitë duhet të kalojnë drejt buxhetimit në nivel produkti për shërbimet sociale, duke identifikuar qartë projektet e financuara nga Fondi Social dhe duke parashikuar fonde konkrete nga buxhetet e tyre për vijueshmërinë e shërbimeve. Kjo qasje do të mundësonte transparencë më të madhe, gjurmueshmëri të shpenzimeve dhe një angazhim real financiar nga ana e njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Analiza e tipologjisë së shërbimeve tregon një fokus të theksuar tek shërbimet për të moshuarit, veçanërisht për vitin 2025. Ndërkohë, kategori të tjera vulnerabël, si individët me varësi nga substancat, viktimat e trafikimit, komuniteti LGBTI, personat e pastrehë apo grupe të tjera të marginalizuara, përmenden rrallë ose nuk përfshihen fare në shumicën e bashkive. Kjo sugjeron një mbulim të pabarabartë të nevojave sociale dhe mungesë të një qasjeje gjithëpërfshirëse në planifikimin e shërbimeve.

Një problematikë shtesë lidhet me lidhjen e dobët ndërmjet Planeve Vendore Sociale dhe aplikimeve


për Fondin Social. Edhe pse shumica e bashkive kanë miratuar plane, procesi i planifikimit shpesh nuk reflekton një analizë të detajuar të nevojave reale të komunitetit dhe nuk shoqërohet me prioritet të qarta, të matshme dhe të monitorueshme. Si pasojë, aplikimet për Fondin Social jo gjithmonë bazohen në një qasje strategjike të orientuar nga nevojat konkrete të popullsisë.

Në disa raste janë konstatuar edhe mospërputhje midis deklarimeve të bashkive dhe të dhënave të institucioneve qendrore lidhur me aplikimet dhe përfitimet nga Fondi Social për vitin 2025. Këto paqartësi rrisin rrezikun për keqinformim publik dhe çënojnë besimin në procesin e menaxhimit të fondeve publike.

Në tërësi, gjetjet tregojnë se, ndonëse Fondi Social ka sjellë përfitime të prekshme për komunitetet, funksionimi i tij vijon të ndikohet nga mungesa e transparencës, koordinimit institucional, standardizimit të raportimit dhe planifikimit të qëndrueshëm. Këto problematika kufizojnë ndikimin afatgjatë të ndërhyrjeve sociale dhe kërkojnë ndërhyrje të strukturuar në nivel politikëbërjeje dhe zbatimi.

Në këtë kontekst, përmirësimi i qeverisjes së Fondit Social kërkon një qasje më të koordinuar dhe më të orientuar drejt rezultateve. Raportimi financiar dhe programor duhet të bëhet më i unifikuar, i detajuar dhe i aksesueshëm për publikun, duke përfshirë informacion të qartë mbi vlerat e financimit, shërbimet e ofruara dhe rezultatet e arritura. Publikimi i rregullt i raporteve vjetore dhe krijimi i një databaze të hapur do të forconin ndjeshëm transparencën dhe llogaridhënien.

Po aq e rëndësishme është edhe rritja e koordinimit ndërinstitutional, në mënyrë që të shmangen mospërputhjet në të dhëna dhe të garantohet një pasqyrë e përbashkët dhe e besueshme mbi funksionimin e Fondit Social. Harmonizimi i metodologjive të raportimit dhe qartësimi i mënyrës së llogaritjes së shifrave do të ndihmonin në ndërtimin e besimit publik dhe në përmirësimin e cilësisë së monitorimit.



Në nivel vendor, përveç kalimit drejt buxhetimit në nivel produkti, nevojitet edhe një angazhim më i fortë për integrimin e shërbimeve sociale në planifikimin buxhetor afatmesëm. Parashikimet financiare duhet të shoqërohen me vlera konkrete dhe me angazhime reale për bashkëfinancim, në mënyrë që shërbimet të mos varen vetëm nga ciklet vjetore të Fondit Social. Kjo do të forconte qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve dhe do të siguronte vazhdimësi për përfituesit.

Gjithashtu, planifikimi i shërbimeve duhet të bazohet më qartë në analizën e nevojave reale të komunitetit, duke përfshirë një gamë më të gjerë grupesh vulnerabël. Një qasje më gjithëpërfshirëse do të ndihmonte në adresimin e boshllëqeve aktuale në mbulim dhe në garantimin e barazisë në aksesin ndaj shërbimeve sociale.

Nëse Fondi Social synon të shndërrohet në një instrument të qëndrueshëm dhe strategjik të zhvillimit social, përtej një mekanizmi financiar afatshkurtër, atëherë investimi në transparencë, koordinim, planifikim dhe llogaridhënie duhet të jetë po aq i rëndësishëm sa edhe vetë investimi financiar.

ANALIZA E FINANCIMIT DHE TRENDEVE 2023–2025

Analiza e financimit të Fondit Social për periudhën 2023–2025 tregon një rritje graduale të vlerës totale të fondeve të akorduara, si dhe një zgjerim të numrit të bashkive përfituese. Sipas të dhënave të përcjella nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në vitin 2023 Fondi Social financoi 33 bashki me një vlerë totale prej rreth 88.4 milionë lekësh (ndërkohë që Shërbimi Social Shtetëror raporton vlerën prej 85.8 milionë lekësh. Në vitin 2024, numri i bashkive përfituese u rrit në 45, me një fond total prej rreth 131.8 milionë lekësh, ndërsa në vitin 2025 u financuan 53 bashki me një vlerë totale prej rreth 150.9 milionë lekësh.

Kjo rritje tregon një angazhim të shtuar të qeverisë për mbështetjen e shërbimeve sociale në nivel vendor.


Megjithatë, rritja e financimit nuk është shoqëruar gjithmonë me rritje proporcionale të transparencës dhe koherencës në raportim. Krahasimi i të dhënave ndërmjet MSHMS, SHSSH dhe bashkive nxjerr në pah mospërputhje të vazhdueshme në vlerat e raportuara, veçanërisht për vitet 2023 dhe 2024, duke vënë në pikëpyetje besueshmërinë e sistemit të raportimit financiar.

Një tjetër trend i rëndësishëm lidhet me numrin e shërbimeve të ofruara. Në vitin 2023 u financuan 34 shërbime, në vitin 2024 – 46 shërbime, ndërsa në vitin 2025 – 57 shërbime. Edhe pse numri total i shërbimeve ka ardhur në rritje, numri i shërbimeve të reja ka pësuar një ulje në vitin 2025 krahasuar me vitet e mëparshme. Kjo sugjeron se fokusi i financimit po zhvendoset më shumë drejt mbështetjes së shërbimeve ekzistuese sesa drejt krijimit të shërbimeve të reja.

Nga ana gjeografike, Fondi Social ka shtrirë gradualisht mbulimin në më shumë bashki. Megjithatë, jo të gjitha bashkitë përfitojnë në mënyrë të vazhdueshme nga financimi, dhe disa prej tyre rezultojnë me cikle të ndërprera përfitimi. Kjo krijon pabarazi në aksesin ndaj shërbimeve sociale dhe rrezikon që komunitete të caktuara të mbeten pa mbështetje të qëndrueshme.

Një aspekt tjetër kritik është mungesa e informacionit të detajuar për vlerat e financimit sipas bashkive për vitin 2025. Ndryshe nga vitet e mëparshme, ku ishin të disponueshme shumat për secilën bashki, këtë vit MSHMS ka raportuar vetëm vlera totale të grupuara. Ndërsa SHSSH ka ofruar informacion për të gjitha vitet por për disa prej bashkive që ofrojnë më shumë se një shërbim ka ofruar informacion të pjesshëm psh. për Bashkinë Lezhë, Vlorë, duke u fokusuar kryesisht tek shërbimet e reja. Kjo e ka bërë të pamundur analizën e plotë krahasuese të financimit në nivel bashkie dhe ka kufizuar ndjeshëm transparencën.

Në lidhje me qëndrueshmërinë financiare, ndonëse një pjesë e bashkive deklarojnë se kanë parashikuar fonde në buxhetet e tyre afatmesme për vazhdimin e shërbimeve, vetëm pak prej tyre kanë ofruar vlera konkrete. Ministria e Financave konfirmon se



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

shumica e bashkive ende nuk përdorin metodologjinë e buxhetimit në nivel produkti, çka e bën të vështirë identifikimin e fondeve specifike të dedikuara për shërbimet e Fondit Social në buxhetet vendore.

Analiza e trendeve tregon gjithashtu një orientim tematik drejt shërbimeve për të moshuarit, veçanërisht në vitin 2025. Ndërkohë, shërbimet për kategori të tjera vulnerabël, si viktimat e trafikimit, personat me varësi nga substancat apo komuniteti LGBTI, mbeten të kufizuara ose mungojnë plotësisht në shumicën e bashkive. Kjo sugjeron se financimi nuk është gjithmonë i orientuar në mënyrë të balancuar sipas spektrit të gjerë të nevojave sociale.

Në përmblendhje, të dhënat për periudhën 2023–2025 tregojnë një rritje të investimit publik në Fondin Social dhe një zgjerim të mbulimit territorial të shërbimeve. Megjithatë, mungesa e transparencës, mospërputhjet në raportim, informacioni i pjesshëm për vitin 2025 dhe pasiguria mbi qëndrueshmërinë financiare të shërbimeve mbeten sfida serioze. Pa adresimin e këtyre problematikave, rritja e fondeve rrezikon të mos përkthehet në ndikim të qëndrueshëm dhe të matshëm për grupet më vulnerabël të shoqërisë.

Në grafikun më poshtë paraqitet vlera totale e Fondit Social për vitet 2023–2025.


Nëse i referohemi numrit të bashkive përfituese dhe numrit të shërbimeve të ofruara prej tyre (të reja dhe vijuese), konstatohet se:



- Për vitin 2023 janë mbështetur financiarisht 33 bashki për 34 shërbime (12 të reja dhe 22 shërbime vijuese).
- Për vitin 2024 janë mbështetur financiarisht 45 bashki për 46 shërbime (15 të reja dhe 31 shërbime vijuese);
- Për vitin 2025 janë mbështetur financiarisht 53 bashki për 57 shërbime (11 të reja dhe 46 shërbime vijuese);

ANALIZA E SHTRIRJES SË FONDIT SOCIAL DHE VITEVE TË ZBATIMIT

Përveç rritjes së vlerës totale të financimit, analiza e Fondit Social për periudhën 2023–2025 tregon edhe një zgjerim të ndjeshëm të shtrirjes territoriale

FIGURA 1 - VLERA TOTALE E FINANCUAR E FONDIT SOCIAL PËR VITET 2023-2025 (MLN LEKË)




FIGURA 2 - SHËRBIME TOTALE 2023 - 2025 (BASHKI PËRFITUESE)


të skemës së financimit në nivel vendor. Numri i bashkive përfituese është rritur nga 33 në vitin 2023, në 45 në vitin 2024, dhe në 53 në vitin 2025, duke reflektuar një mbulim gjithnjë e më të gjerë të territorit të vendit me shërbime sociale të financuara nga Fondi Social.

Megjithatë, analiza e fazave të zbatimit të shërbimeve tregon se bashkitë ndodhen në nivele të ndryshme të përfitimit nga skema e financimit. Për vitin 2025, 11 bashki janë në vitin e parë të mbështetjes financiare, ndërsa pjesa tjetër ndodhen në vitin e dytë, të tretë, të katërt, të pestë apo të gjashtë të zbatimit të shërbimeve.


Bashkitë që janë në vitin e parë të përfitimit janë: Shijak, Krujë, Pustec, Divjakë, Kuçovë, Përmet, Finiq, Vorë, Vlorë (shërbimi i dytë), Durrës (shërbimi i dytë) dhe Elbasan (shërbimi i dytë). Këto bashki kanë nisur së fundmi ofrimin e shërbimeve sociale të financuara nga Fondi Social, çka kërkon vëmendje të shtuar në aspektin e monitorimit dhe cilësisë së zbatimit.

Një grup më i madh bashkish ndodhen në vitin e dytë dhe të tretë të përfitimit, duke përfshirë bashki si Dimal, Mat, Vau i Dejës, Memaliaj, Dropull, Fushë-

Arrëz, Dibër, Libohovë, Has, Kurbin, Këlcyrë, Patos, Gjirokastrë, Lushnjë dhe Tiranë. Këto bashki kanë kaluar fazën fillestare të zbatimit dhe ndodhen në një fazë konsolidimi të shërbimeve sociale.

Ndërkohë, bashki si Shkodër, Delvinë, Sarandë, Tepelenë, Devoll, Malësi e Madhe, Kolonjë dhe Roskovec ndodhen në vitin e katërt të përfitimit, ndërsa bashki të tjera si Rrogozhinë, Elbasan, Vlorë, Korçë, Kukës, Berat, Belsh dhe Përrenjas janë në vitin e pestë. Vetëm tre bashki – Durrës, Librazhd dhe Lezhë – ndodhen në vitin e gjashtë të përfitimit nga Fondi Social.


Kjo shpërndarje tregon se një pjesë e konsiderueshme e bashkive janë ende në faza relativisht të hershme të zbatimit, ndërsa vetëm një numër i kufizuar kanë përvojë afatgjatë në ofrimin e shërbimeve të financuara nga Fondi Social. Kjo situatë nënvizon nevojën për monitorim të diferencuar sipas fazës së zbatimit, si dhe për politika të posaçme që garantojnë që shërbimet të mos ndërpriten pas përfundimit të periudhës së financimit.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

FIGURA 3 - VITI AKTUAL I ZBATIMIT TË FONDIT SOCIAL



MOSPËRPUTHJE DHE MANGËSI NË RAPORTIMIN E APLIKIMEVE DHE PËRFITIMIT NGA FONDI SOCIAL 2025

Analiza e të dhënave të raportuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) për periudhën 2023–2025 evidenton mospërputhje në raportimin financiar dhe programor të Fondit Social.

Këto mospërputhje lidhen me:

- o mungesën e të dhënave të detajuara për vitin 2025;
- o diferenca në vlerat financiare të raportuara për të njëjtat shërbime;
- o raportim të pjesshëm nga disa bashki për shërbimet vijuese.


Në përputhje me ndarjen institucionale të përgjegjësisë, MSHMS është përgjegjëse për pasqyrën kombëtare të financimeve, SHSSH për

monitorimin teknik të shërbimeve, ndërsa bashkitë për raportimin e zbatimit në nivel vendor. Mungesa e një formati të unifikuar raportimi dhe e publikimit sistematik të të dhënave ka krijuar mospërputhje në informacionin e disponueshëm për publikun dhe aktorët monitorues.

MUNGESA E TË DHËNAVE TË DETAJUARA PËR VITIN 2025

Për vitin 2025, MSHMS ka raportuar vetëm vlerën totale të Fondit Social, pa ndarje sipas bashkive përfituese. SHSSH ka vënë në dispozicion informacion të detajuar për bashkitë me shërbime të reja, dhe vijuese por për tre nga bashkitë, atë të Lezhës, Elbasanit dhe Vlorës informacioni mbi vlerat e financimit ka pasur mospërputhje. Për shërbimin e parë në bashkinë Lezhë, vlerat janë totalisht të ndryshme krahasuar me raportimin e vetë bashkisë, ndërsa për shërbimin e dytë nuk jepet asnjë informacion.

Nga ana tjetër për shërbimin e parë të bashkisë Elbasan, nuk jepet informacion mbi vlerën e financimit për vitin 2025 ndërkohë që bashkia e raporton.



Në bashkinë Vlorë, për shërbimin e parë, vlerat e financimit për vitin 2023 nuk përputhen dhe për vitin 2025 mungon informacioni nga ana e SHSSH-së.

Si rezultat, kryerja e një analize krahasuese mbi shpërndarjen e fondeve në nivel vendor për vitin 2025 ka qenë e vështirë.

Referuar të dhënave të raportuara nga 57 bashki, rezulton se 24 bashki kanë aplikuar për të përfituar nga Fondi Social në vitin 2025, ndërsa vetëm 11 prej tyre janë shpallur fituese. Megjithatë, edhe për këto bashki, informacioni mbi statusin e aplikimit, përfitimit dhe vlerat e financimit nuk është i unifikuar ndërmjet burimeve institucionale.

MOSPËRPUTHJE NË STATUSIN E APLIKIMIT DHE PËRFITIMIT

Bashkia Durrës

Bashkia Durrës nuk ka përcjellë informacion nëse ka aplikuar apo përfituar nga Fondi Social për vitin 2025. Në kontrast, të dhënat e MSHMS dhe SHSSH tregojnë se kjo bashki është shpallur fituese për financimin e shërbimit të dytë në vitin 2025.

Për shërbimin e parë, bashkia nuk ka dhënë informacion mbi vlerat e financimit sipas viteve. Të dhënat janë marrë nga raportimet e mëparshme të MSHMS dhe SHSSH dhe nuk është e qartë nëse shërbimi është ende vijues në vitin 2025 apo ka përfunduar.

Për shërbimin e dytë (i ri në 2025), të dhënat financiare janë marrë nga SHSSH, pasi bashkia nuk ka ofruar informacion.

Bashkia Vlorë

Në përgjigjen e saj zyrtare, Bashkia Vlorë konfirmon se nuk ka aplikuar për të përfituar nga Fondi Social për vitin 2025. Megjithatë, sipas të dhënave të MSHMS dhe SHSSH, kjo bashki rezulton fituese për financimin e një shërbimi të ri në vitin 2025.

Kjo mospërputhje është e njëjtë me problematikën e konstatuar në analizën financiare të Vlorës, ku për vitin 2025 vërehen edhe diferenca të ndjeshme ndërmjet vlerave të raportuara nga bashkia dhe SHSSH për shërbimin “Qendër Ditore për të Moshuarit”.

Bashkia Kavajë

Bashkia Kavajë nuk është përfshirë në analizën e vlerave të financimit për Fondin Social 2025, pasi nuk rezulton të ketë qenë përfituese e Fondit Social për vitet 2023, 2024 dhe 2025.


DIFERENCA NË RAPORTIMIN FINANCIAR NDËRMJET MSHMS DHE SHSSH

Në disa bashki janë konstatuar diferenca në vlerat financiare të raportuara nga MSHMS dhe SHSSH për të njëjtin projekt.

Në rastin e Bashkisë Elbasan, të dhënat e raportuara për periudhën 2023–2025 tregojnë përmirësim në qartësinë e raportimit nga ana e bashkisë, por njëkohësisht evidentojnë mospërputhje të rëndësishme ndërmjet të dhënave të bashkisë dhe atyre të institucioneve qendrore, veçanërisht për vitin 2025.

TABELA 1 - PROJEKTI 1: “QENDRA MULTIFUNKSIONALE SHUSHICË”

Viti	Bashkia	MSHMS	SHSSH
2023	2,157,575 lekë	1,715,945.16 lekë	1,715,945.16 lekë
2024	1,715,945 lekë	1,715,945 lekë	1,715,945 lekë
2025	1,715,945 lekë	Nuk jepet informacion	Nuk jepet informacion



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

TABELA 2 - PROJEKTI 2: “FIT PËR JETËN” (SHËRBIM I RI NË 2025)

Viti	Bashkia	MSHMS	SHSSH
2025	9,035,673 lekë	Nuk jepet informacion	10,751,618 lekë

Nga krahasimi i të dhënave rezulton se:

- Për vitin 2023, bashkia raporton një vlerë më të lartë financimi (2,157,575 lekë) krahasuar me MSHMS dhe SHSSH (1,715,945.16 lekë).
- Për vitin 2024, të tre burimet raportojnë të njëjtën vlerë (1,715,945 lekë), duke treguar për një harmonizim të përkohshëm të të dhënave.
- Për vitin 2025, bashkia deklaron vijueshmëri të shërbimit me financim prej 1,715,945 lekësh, ndërsa MSHMS dhe SHSSH nuk japin asnjë informacion financiar.

Mungesa e të dhënave nga institucionet qendrore për vitin 2025 kufizon mundësinë për verifikim të pavarur të vijueshmërisë së financimit dhe cenon transparencën e përdorimit të fondeve publike për këtë shërbim.

Për projektin e dytë, i cili është shërbim i ri në vitin 2025, konstatohet se:

- Bashkia raporton një vlerë financimi prej 9,035,673 lekësh.
- SHSSH raporton një vlerë më të lartë, prej 10,751,618 lekësh.
- MSHMS nuk jep asnjë informacion për këtë projekt.

Diferenca prej rreth 1.7 milionë lekësh ndërmjet bashkisë dhe SHSSH nuk shoqërohet me shpjegim mbi metodologjinë e raportimit apo statusin e pagesave, duke krijuar paqartësi mbi vlerën reale të financimit për këtë shërbim.

MOSPËRPUTHJE NË RAPORTIMIN E SHËRBIMEVE – BASHKIA VLORË

Në rastin e Bashkisë Vlorë, mospërputhjet në raportimin e vlerave të financimit të shërbimeve sociale konstatohet si për periudhën 2023–2024, ashtu edhe për vitin 2025. Këto mospërputhje lidhen si me diferenca ndërmjet të dhënave të bashkisë dhe atyre të MSHMS dhe SHSSH, ashtu edhe me mungesë informacioni të plotë nga institucionet qendrore.

Nga krahasimi i të dhënave rezulton se:

- Për vitin 2023, SHSSH raporton një vlerë financimi më të lartë (6,278,524 lekë) krahasuar me bashkinë dhe MSHMS (3,971,724 lekë).
- Për vitin 2024, të tre burimet raportojnë të njëjtën vlerë, duke reflektuar përputhje të përkohshme të të dhënave.
- Për vitin 2025, bashkia deklaron vijueshmëri të shërbimit me financim prej 3,971,724 lekësh, ndërsa MSHMS dhe SHSSH nuk japin informacion financiar.

TABELA 3 - PROJEKTI 1: “NGRITJA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN ME BAZË KOMUNITARE (PARANDALIMI I INSTITUCIONALIZIMIT DHE DEINSTITUCIONALIZIMI I FËMIJËVE NGA INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR)”

Viti	Bashkia	MSHMS	SHSSH
2023	3,971,724 lekë	3,971,724 lekë	6,278,524 lekë
2024	3,971,724 lekë	3,971,724 lekë	3,971,724 lekë
2025	3,971,724 lekë	Nuk jepet informacion	Nuk jepet informacion




TABELA 4 - PROJEKTI 2: “QENDËR DITORE PËR TË MOSHUARIT”

Viti	Bashkia	MSHMS	SHSSH
2025	4,413,247 lekë	Nuk jepet informacion	8,384,971 lekë

Mungesa e të dhënave nga institucionet qendrore për vitin 2025 kufizon verifikimin e pavarur të vijueshmërisë së financimit për këtë shërbim.

- Edhe kur bashkia raporton vlera të detajuara, mungesa e harmonizimit institucional pengon verifikimin e pavarur të të dhënave.

PROJEKTI 2: “QENDËR DITORE PËR TË MOSHUARIT”

Për këtë projekt, i cili është shërbim i ri në vitin 2025, konstatohet se:

- Bashkia raporton një vlerë financimi prej 4,413,247 lekësh.
- SHSSH raporton një vlerë ndjeshëm më të lartë, prej 8,384,971 lekësh.
- MSHMS nuk ka publikuar asnjë informacion për këtë shërbim..

Diferenca prej rreth 3,97 milionë lekësh ndërmjet bashkisë dhe SHSSH nuk shoqërohet me shpjegim metodologjik mbi bazën e llogaritjes së shifrave.

Rasti i Bashkisë Vlorë tregon se:

- Mospërputhjet në raportimin e vlerave financiare kanë qenë të pranishme edhe në vitet e mëparshme.
- Për vitin 2025, mungesa e informacionit nga MSHMS dhe diferencat me SHSSH kufizojnë ndjeshëm transparencën.

Ky rast nënvizon nevojën për standardizim të raportimit financiar dhe publikim të detajuar të të dhënave nga institucionet qendrore.

MUNGESË INFORMACIONI NGA INSTITUCIONET QENDRORE PËR DISA BASHKI

Bashkia Tiranë

Për vitin 2024, Bashkia Tiranë ka përfutur financim prej 6,793,340 lekësh. Për vitin 2025, pavarësisht se shërbimi është vijues, nuk jepet asnjë informacion financiar nga bashkia, MSHMS ndërsa SHSSH raporton vlerën prej 4,940,611 lekë.


Bashkitë Shkodër dhe Lezhë

Për shërbimin e parë në bashkinë Lezhë, vlerat financiare të raportuara nga ana e bashkisë janë totalisht të ndryshme krahasuar me të dhënat e MSHMS dhe SHSSH. Tabela 5.

Ndërsa për shërbimin e dytë, as MSHMS dhe as SHSSH nuk kanë dhënë asnjë informacion për asnjë

TABELA 5

Viti	Bashkia	MSHMS	SHSSH
2023	1,172,000 lekë	2,503,632 lekë	3,373,108 lekë
2024	1,172,000 lekë	1,172,000 lekë	3,901,299 lekë
2025	1,172,000 lekë	Nuk jepet informacion	2,744,443 lekë



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

TABELA 6

Viti	Bashkia	MSHMS	SHSSH
2023	2,201,108 lekë	2,201,108 lekë	Nuk jepet informacion
2024	2,729,299 lekë	2,729,299 lekë	Nuk jepet informacion
2025	1,572,443 lekë	Nuk jepet informacion	Nuk jepet informacion

vit, por ju referuam të dhënave nga raportimet e mëparshme të këtyre institucioneve. Tabela 6.

Bashkitë Sarandë dhe Korçë

Për vitin 2025, të dhënat mbeten vetëm ato të deklaruara nga bashkitë, pasi MSHMS dhe SHSSH nuk kanë përcjellë informacion përkatës.

Bashkia Fier

Bashkia Fier raporton një vlerë totale për periudhën 2023–2025, pa ndarje të qartë sipas viteve, duke kufizuar analizën vjetore të financimit.

Mospërputhjet e evidentuara dobësojnë koherencën e raportimit financiar, kufizojnë transparencën publike, pengojnë analizën krahasuese ndërmjet bashkive, ulin besueshmërinë e të dhënave zyrtare si dhe vështirësojnë vlerësimin e ndikimit të Fondit Social. Pa harmonizim të formateve të raportimit dhe publikim të rregullt të të dhënave, monitorimi efektiv i Fondit Social mbetet i kufizuar.

SHUMAT E AKORDUARA PËR SECILËN BASHKI

Analizë krahasuese e financimit nga Fondi Social (2023–2025)

Pas evidentimit të mospërputhjeve dhe mangësive në raportimin e aplikimeve dhe përfitimit nga Fondi Social për vitin 2025, ky seksion analizon shpërndarjen e fondeve sipas bashkive për periudhën 2023–2025, me fokus në vlerat e financimit të raportuara, pabarazitë ndërmjet njësive të vetëqeverisjes

vendore dhe kufizimet në transparencën financiare.

Analiza bazohet në të dhënat e disponueshme nga bashkitë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH). Për vitin 2025, vlerësimi është i kufizuar për shkak të mungesës së informacionit të detajuar për shërbimet vijuese, siç u theksua në seksionin e mëparshëm.


1. PANOAMA E PËRGJITHSHME E FINANCIMIT SIPAS BASHKIVE

Të dhënat për vitet 2023 dhe 2024 tregojnë se shpërndarja e fondeve nga Fondi Social nuk ka qenë uniforme ndërmjet bashkive. Disa bashki kanë përfituar vlera relativisht të larta dhe të qëndrueshme financimi ndër vite, ndërsa të tjera kanë përfituar fonde më të kufizuara ose vetëm për shërbime të reja.

Për vitin 2025, për shkak të raportimit të pjesshëm nga institucionet qendrore, analiza e shumave të akorduara është e mundur vetëm për një numër të kufizuar bashkish, kryesisht ato që kanë nisur shërbime të reja. Kjo situatë kufizon ndjeshëm mundësinë për të ndërtuar një pasqyrë të plotë dhe krahasuese të financimit në nivel vendor.

2. BASHKITË ME NIVELE TË LARTA FINANCIMI NË PERIUDHËN 2023–2024

Në periudhën 2023–2024, disa bashki rezultojnë të kenë përfituar vlera të konsiderueshme nga Fondi Social për ofrimin e shërbimeve sociale, veçanërisht për shërbime me karakter komunitar dhe mbështetës.

**Bashkia Elbasan**

2023: 2,157,575 lekë (sipas bashkisë) / 1,715,945.16 lekë (sipas MSHMS dhe SHSSH)

2024: 1,715,945 lekë

Bashkia Vlorë

2023: 3,971,724 lekë (sipas bashkisë dhe MSHMS) / 6,278,524 lekë (sipas SHSSH)

2024: 3,971,724 lekë

Bashkia Durrës

2023: 3,536,784 lekë

2024: 3,536,784 lekë

Këto bashki kanë pasur financime relativisht të qëndrueshme për shërbimet ekzistuese. Megjithatë, siç u evidentua në seksionin e mospërputhjeve, për disa prej tyre mungojnë të dhënat për vijueshmërinë e financimit në vitin 2025, çka kufizon vlerësimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve.

3. FINANCIMET PËR SHËRBIMET E REJA NË VITIN 2025

Për vitin 2025, të dhënat e disponueshme nga SHSSH tregojnë se financimet janë përqendruar kryesisht në shërbime të reja.

Bashkia Elbasan – Projekti “Fit për Jetën”

Bashkia: 9,035,673 lekë

SHSSH: 10,751,618 lekë

Bashkia Vlorë – “Qendër Ditore për të Moshuarit”

Bashkia: 4,413,247 lekë

SHSSH: 8,384,971 lekë

Bashkia Durrës – Shërbimi 2

SHSSH: 10,146,961 lekë

Në të tre rastet, vërehen diferenca të ndjeshme ndërmjet vlerave të raportuara nga bashkitë dhe atyre të raportuara nga SHSSH, si dhe mungesë informacioni nga MSHMS. Këto mospërputhje kufizojnë transparencën dhe e bëjnë të vështirë verifikimin e pavarur të vlerave reale të financimit.

4. BASHKITË ME MUNGESË TË DHËNASH TË STRUKTURUARA PËR FINANCIMIN

Për disa bashki, analiza e shumave të akorduara është e kufizuar për shkak të mungesës së informacionit të detajuar dhe të harmonizuar:

Bashkia Tiranë

2024: 6,793,340 lekë

2025: mungesë e plotë e të dhënave për shërbimin vijues

Bashkitë Shkodër dhe Lezhë

Të dhënat bazohen kryesisht në raportimet e bashkive.

Mungon verifikimi nga MSHMS për vitin 2025.


Bashkitë Sarandë dhe Korçë

2025: vetëm të dhëna nga bashkitë dhe SHSSH, mungojnë të dhënat nga MSHMS

Bashkia Fier

Raporton një vlerë totale për periudhën 2023–2025, pa ndarje sipas viteve

Këto kufizime pengojnë analizën vjetore të financimit dhe e bëjnë të pamundur krahasimin e saktë ndërmjet bashkive.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

5. VLERËSIM KRAHASUES DHE PABARAZI NË SHPËRNDARJEN E FONDEVE

Nga analiza e të dhënave rezulton se:


- Shpërndarja e fondeve nuk ka qenë uniforme ndërmjet bashkive.
- Bashkitë me shërbime të reja në vitin 2025 kanë përfituar vlera relativisht të larta financimi.
- Për shërbimet vijuese mungon transparenca mbi vijueshmërinë e financimit.

- Diferencat ndërmjet burimeve institucionale e vështirësojnë analizën krahasuese.


Këto elemente sugjerojnë nevojën për një sistem më të qartë dhe të harmonizuar të raportimit financiar dhe për publikim të rregullt të të dhënave sipas bashkive.

Shumat e akorduara për bashkitë (2023–2024) dhe Financimet për shërbimet e reja në 2025 paraqiten në tabelën sa më poshtë.

Nr.	Bashkia	TE DHENAT REFERUAR MSHMS			TE DHENAT REFERUAR SHSSH			Viti aktual i Zbatimit te Fondit Social
		Vlera e financuar per vitin 2023(Lekë)	Vlera e financuar per vitin 2024 (Lekë)	Vlera e financuar per vitin 2025	Vlera e financuar per vitin 2023 (Lekë)	Vlera e financuar per vitin 2024 (Lekë)	Vlera e financuar per vitin 2025 (Lekë)	
1	Bashkia Durrës Sherbimi 1	3,536,784	3,536,784		3,536,784	3,536,784		6
	Bashkia Durrës Sherbimi 2						10,146,961	1
2	Bashkia Fier	2,383,160 L	3,093,403		2,383,160	3,093,403	1,572,899	3
3	Bashkia Roskovec	1,156,050	1,023,000		1,156,050	1,023,000	1,023,000	4
4	Bashkia Kolonjë	3,523,152	1,761,851		3,523,152	1,636,800	1,636,800	4
5	Bashkia Selenicë	1,780,000	2,328,000		1,780,000	2,328,000	1,164,000	3
6	Bashkia Tepelenë	3,630,240	1,940,240		3,630,240	1,940,240	1,940,240	4
7	Bashkia Sarandë	4,124,972	2,128,508		4,124,972	2,128,508	2,128,508	4
8	Bashkia Delvinë	2,609,800	1,206,368		2,609,800	1,206,368	1,206,368	4
9	Bashkia Vlorë sherbimi 1	3,971,724	3,971,724		6,278,524	3,971,724		5
	Bashkia Vlorë sherbimi 2						8,384,971	1
10	Bashkia Gramsh	2,632,000	3,210,000		2,632,000	3,210,000	1,372,800	3
11	Bashkia Rrogozhinë	2,192,016	2,192,016		2,192,016	2,192,016	2,192,016	5
12	Bashkia Elbasan Sherbimi 1	1,715,945	1,715,945		1,715,945	1,715,945		5
	Bashkia Elbasan Sherbimi 2						10,751,618	1
13	Bashkia Klos	1,938,000	2,258,000		1,938,000	2,258,000	1,575,000	3
14	Bashkia Bulqizë	2,605,000	2,605,000		2,605,000	2,550,000	1,334,400	3
15	Bashkia Kukës	1,665,506	1,665,506		1,665,506	1,665,506	1,665,506	5
16	Bashkia Kamëz	4,368,903	6,241,290		4,368,903	6,241,290	2,496,516	3
17	Bashkia Berat	1,164,000	1,164,000		1,164,000	1,164,000	1,164,000	5



18	Bashkia Belsh	1,233,900	1,233,900		1,233,900	1,233,900	1,233,900	5
19	Bashkia Cërrik	1,576,974	1,094,791		1,576,974	1,904,791	983,162	3
20	Bashkia Maliq	1,618,348	3,126,776		1,618,348	3,126,776	1,152,232	3
21	Bashkia Pogradec	944,256	1,144,324		944,256	1,144,324	566,296	3
22	Bashkia Korcë	3,946,724	3,946,724		3,946,724	3,946,724	3,946,724	5
23	Bashkia Devoll	2,402,667	1,572,750		2,402,667	1,572,464	1,572,464	4
24	Bashkia Poliçan	2,653,952	3,849,998		2,653,952	3,849,998	1,924,999	3
25	Bashkia Librazhd	2,503,632	2,503,632		2,503,632	2,503,632	2,503,632	6
26	Bashkia Prrenjas	2,340,000	2,340,000		2,340,000	2,340,000	2,340,000	5
27	Bashkia Pukë	1,021,800	2,455,200		1,021,800	2,455,200	1,473,120	3
28	Bashkia Lezhë shërbimi 1	2,503,632	1,172,000		3,901,299	3,901,299	2,744,443	6
29	Bashkia Lezhë shërbimi 2	2,201,108	2,729,299		2,201,108			3
30	Bashkia Shkodër	8,612,016	4,158,672		8,612,016	4,158,672	4,158,672	4
31	Bashkia Malësia e Madhe	1,830,000	802,500		1,830,000	802,500	802,500	4
32	Bashkia Patos	1,244,000	2,895,000		1,244,000	2,895,000	2,519,280	2
33	Bashkia Lushnje (2 sherbime)	1,249,600	1,933,340		1,249,600	1,933,340	2,574,270	2
34	Bashkia Gjirokastër	1,987,018	4,779,857		1,987,018	4,779,857	3,267,833	2
35	Bashkia Dimal		1,354,400			1,354,400	1,222,400	2
36	Bashkia Mat		5,368,050			5,368,050	3,070,670	2
37	Bashkia Vau Dejës		3,630,976			3,630,976	2,999,664	2
38	Bashkia Memaliaj		3,314,660			3,314,660	1,924,240	2
39	Bashkia Dropull		5,094,823			5,094,823	5,589,323	2
40	Bashkia Fushë Arrëz		4,069,700			4,069,700	2,665,800	2
41	Bashkia Dibër		4,515,000			4,515,000	2,980,000	2
42	Bashkia Libohovë		3,844,200			3,844,200	3,150,576	2
43	Bashkia Has		4,416,820			4,416,820	3,206,510	2
44	Bashkia Kurbin		2,498,000			2,498,000	2,405,901	2
45	Bashkia Këlcyrë		2,551,988			2,551,988	1,683,862	2
46	Bashkia Tiranë		6,793,340			6,793,340	4,940,611	2
47	Bashkia Përmet						3,897,262	1
48	Bashkia Shijak						3,774,014	1
49	Bashkia Pustec						4,626,657	1
50	Bashkia Vorë						10,461,350	1
51	Bashkia Finiq						1,425,600	1
52	Bashkia Krujë						1,071,000	1
53	Bashkia Divjakë						3,134,093	1
54	Bashkia Kuçovë						1,201,565	1




RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

Të dhënat në grafikun e mëposhtëm reflektojnë shumat e financuara për 10 bashkitë në monitorim, duke mos përfshirë bashkinë Kavajë pasi kjo bashki nuk rezulton të ketë qenë përfituese e Fondit Social për vitet 2023-2024-2025.

FIGURA 4 - VLERA E FINANCUAR PËR BASHKITË NË MONITORIM SIPAS VITIT RESPEKTIV (MIJË)



PLANET VENDORE SOCIALE DHE LIDHJA ME FONDIN SOCIAL

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 111/2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social" përcakton se ministria përgjegjëse për çështjet sociale ka kompetencën të transferojë fonde tek njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore. Ky financim bazohet në planet sociale të hartuara dhe të buxhetuara nga bashkitë, të cilat duhet të jenë të miratuara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në këtë kontekst, për të qenë përfituese e Fondit Social, një bashki duhet të disponojë një Plan Vendor Social të miratuar dhe të buxhetuar. Mungesa e këtij dokumenti përbën pengesë ligjore për aplikimin dhe përfitimin nga skema e financimit.


Bazuar në informacionin e përcjellë nga 56 bashki deri në dhjetor 2025, rezulton se:

- 53 bashki kanë miratuar dhe kanë në fuqi Planet e tyre Vendore Sociale;
- 3 bashki janë ende në proces miratimi: Memaliaj, Pustec dhe Shkodër.

Vlen të theksohet se Bashkia Shkodër ndodhet në këtë status prej më shumë se dy vitesh, çka tregon një vonesë të zgjatur në përmbushjen e këtij kriteri thelbësor ligjor.

Mospasja e një Plani Vendor Social të miratuar kufizon drejtpërdrejt mundësinë e bashkive për të aplikuar dhe përfituar nga Fondi Social, duke ndikuar negativisht në aksesin ndaj financimit për shërbime sociale për grupet në nevojë.

Për të siguruar akses të barabartë në financim dhe për të garantuar vijueshmërinë e shërbimeve sociale në nivel vendor, është e domosdoshme që bashkitë Memaliaj, Pustec dhe Shkodër të përshpejtojnë procesin e miratimit të Planeve të tyre Vendore Sociale.



Në këtë drejtim, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet të ushtrojë një rol më aktiv monitorues dhe mbështetës, duke ofruar asistencë teknike aty ku është e nevojshme për të garantuar përmbushjen e kriterëve ligjore për përfitimin nga Fondi Social.

SHËRBIMET SOCIALE TË OFRUARA NË 2025

Në vitin 2025, shërbimet sociale të financuara përmes Fondit Social vijnë të përqendrohen kryesisht në mbështetjen e grupeve vulnerabël, me fokus të veçantë të të moshuarit, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet në nevojë. Ndërhijet e financuara përfshijnë si shërbime vijuese nga vitet e mëparshme, ashtu edhe shërbime të reja të miratuara në kuadër të thirrjes për vitin 2025.

Megjithatë, për shkak të mungesës së informacionit të plotë dhe të detajuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) për shërbimet vijuese, analiza për vitin 2025 mbështetet kryesisht në të dhënat e raportuara për shërbimet e reja nga SHSSH dhe nga vetë bashkitë. Kjo kufizon ndërtimin e një pasqyre të plotë mbi vijueshmërinë e ndërhyrjeve sociale në nivel vendor.

TIPOLOGJIA E SHËRBIMEVE TË OFRUARA

Shërbimet sociale të financuara në vitin 2025 përfshijnë një gamë ndërhyrjesh që adresojnë nevojat e ndryshme sociale. Ato përfshijnë kryesisht shërbime për të moshuarit, të ofruara në formën e qendrave ditore dhe shërbimeve komunitare mbështetëse; shërbime për fëmijët dhe familjet, me fokus në parandalimin e institucionalizimit dhe në proceset e deinstitutionalizimit; shërbime për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë ndërhyrje rehabilituese dhe mbështetëse; si dhe shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike dhe individët vulnerabël në komunitet.

Dominimi i shërbimeve për të moshuarit dhe për fëmijët reflekton orientimin e politikave sociale drejt grupeve me nevojat të larta për kujdes të vazhdueshëm dhe mbështetje afatgjatë.

SHËRBIMET E REJA TË FINANCUARA NË 2025


Të dhënat e disponueshme nga SHSSH tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e financimeve për vitin 2025 janë përqendruar në shërbime të reja. Këto përfshijnë, ndër të tjera, qendra ditore për të moshuarit (si në Bashkinë Vlorë), shërbime mbështetëse për fëmijët dhe familjet, si dhe projekte me fokus në aktivizimin social dhe përfshirjen komunitare, si projekti "Fit për Jetën" në Bashkinë Elbasan.

Në disa raste, vlerat e financimit për këto shërbime janë relativisht të larta, çka tregon për investime të konsiderueshme në zgjerimin e ofertës së shërbimeve sociale në nivel vendor. Megjithatë, mungesa e informacionit të detajuar nga MSHMS për këto shërbime kufizon verifikimin e plotë të shpërndarjes së fondeve dhe monitorimin e ndikimit të tyre.

SHËRBIMET VIJUESE DHE MUNGESA E TRANSPARENCËS

Për shërbimet që kanë qenë funksionale edhe në vitet e mëparshme, informacioni për vitin 2025 paraqitet i fragmentuar. Në disa bashki, si Tirana, Durrësi, Elbasani dhe Vlora, shërbimet vijuese vazhdojnë të ofrohen, por mungojnë të dhënat e qarta mbi vlerat e financimit, nuk ka raportim të unifikuar nga MSHMS dhe SHSSH, dhe bashkitë nuk kanë përcjellë gjithmonë informacion të detajuar financiar.

Kjo situatë kufizon vlerësimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve dhe e bën të vështirë analizën e kostos reale për ofrimin e tyre, si dhe planifikimin afatmesëm të ndërhyrjeve sociale.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

TABELA 5 - KATEGOTIA E PËRFITUESËVE SIPAS ÇDO BASHKIE

Bashkia	Kategoria e përfituesve:	Tipologjia e shërbimit 2024
Bashkia Shijak	Fëmijët dhe të rinjtë me AK	Qendër Komunitare Multifunkionale për Fëmijët me AK
Bashkia Krujë	Të moshuarit, personat me ndihmë ekonomike, personat me AK, romët dhe egjiptianët, gratë e veja, gratë e dhunuara apo fëmijët e braktisur apo të dhunuar, apo të rinjtë në vështirësi	Qendër Multifunkionale ditore
Bashkia Pustec	Personat me Aftësi Të Kufizuar, Familjet e PAK, Popullsia e izoluar dhe Vunerabël, Kujdestar dhe Staf Shëndetësor /Social, të Moshuarit	Shërbime Sociale dhe Kujdesi për Persona me Aftësi të Kufizuar/shërbim lëvizës
Bashkia Divjakë	Terapi zhvillimi, Terapi individuale dhe në grup, Terapi, Fizioterapi, Terapi të foluri, Logopedi	Shërbime Komunitare të Integruara për fëmijë në nevojë
Bashkia Kuçovë	Fëmijë me AK, fëmijë me probleme logopedike, dhe moshë e tretë.	Shërbime ditore për të moshuarit dhe shërbim në familje për PAK
Bashkia Përmet	Të moshuarit e vetmuar; personat me AK; personat në situatë vunerabiliteti të shumëfishtë	Qendër ditore për të moshuarit e vetmuar; personat me AK; personat në situatë vunerabiliteti të shumëfishtë
Bashkia Finiq	Të moshuar	Shërbim lëvizës
Bashkia Vorë	Të moshuar	Shërbime për të moshuar; shërbime higjieno-sanitare; shërbime mirëmbajtje dhe furnizime bazë për nevojat e përditshme; shërbime transporti dhe logjistike; shpenzime për medikamente; shpenzime ushqimore etj;
Bashkia Vlorë (shërbimi i dytë i financuar)	Të moshuar	Qendër Ditore për të Moshuarit, vakt ushqimor për të moshuarit, aktivitete psiko-sociale
Bashkia Durrës (shërbimi i dytë i financuar)	Fëmijë; Familje me nevoja sociale	Qendër emergjence ditore
Bashkia Elbasan (shërbimi i dytë i financuar)	Të moshuar	Qendër Multifunkionale Ditore për të Moshuarit, shërbime të ndryshme shëndetësore, psikologjike dhe sociale për të moshuarit


MBULIMI TERRITORIAL I SHËRBIMEVE

Shërbimet sociale të financuara në vitin 2025 nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në të gjithë territorin e vendit. Disa bashki kanë përfituar financime për më shumë se një shërbim, ndërsa të tjera kanë përfituar vetëm për një projekt ose nuk kanë përfituar fare.

Bashkitë që kanë aplikuar dhe janë shpallur fituese për shërbime të reja kanë përfituar vlera relativisht të larta financimi, ndërsa bashkitë që mbështeten

vetëm në shërbime vijuese përballen me pasiguri financiare për shkak të mungesës së informacionit të qartë mbi vijueshmërinë e fondeve.

Analiza e shërbimeve sociale të ofruara në vitin 2025 tregon se fokusi kryesor mbetet te shërbimet komunitare për të moshuarit dhe fëmijët, ndërsa financimi për shërbimet e reja është më i dukshëm sesa për shërbimet vijuese. Transparenca mbi vijueshmërinë e shërbimeve ekzistuese mbetet e kufizuar dhe shpërndarja territoriale e shërbimeve nuk është uniforme.



Këto elemente nënvizojnë nevojën për një sistem më të qartë raportimi dhe monitorimi të shërbimeve sociale, veçanërisht për shërbimet vijuese, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë, cilësisë dhe ndikimit afatgjatë të ndërhyrjeve sociale në nivel vendor.

Nga ballafaqimi i raportimeve nga institucionet qendrore dhe vetë bashkive, rezultoi se për bashkinë Krujë, pavarësisht se SHSSH raporton vlerën specifike të fondit apo dhe kategoritë/ tipologjinë e shërbimit/ eve që do të ofrohen në këtë bashki, vetë bashkia Krujë raporton se projekti nuk është zbatuar dhe për vitin 2025 nuk ka asnjë vlerë të disbursuar nga Ministria.

Të dhënat mbi bashkinë Finiq janë marrë vetëm nga SHSSH pasi vetë bashkia nuk ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion dërguar nga Faktaje.

QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE DHE PLANIFIKIMI BUXHETOR

Qëndrueshmëria financiare e shërbimeve sociale përbën një element thelbësor për garantimin e vazhdimësisë, cilësisë dhe ndikimit afatgjatë të ndërhyrjeve sociale në nivel vendor. Në kuadër të Fondit Social, kjo qëndrueshmëri varet drejtpërdrejt nga mënyra se si bashkitë i integrojnë shërbimet sociale në planifikimin e tyre buxhetor afatmesëm, nga niveli i bashkëfinancimit vendor dhe nga koherenca ndërmjet financimit qendror dhe burimeve të veta.

PLANIFIKIMI BUXHETOR AFATMESËM DHE ROLI I BASHKIVE

Në lidhje me pyetjen nëse bashkitë kanë parashikuar fonde në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028 për ofrimin e shërbimeve sociale sipas VKM nr. 518/2018, në mënyrë të pavarur nga financimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministria e Financave (MF) ka konfirmuar se:

Bashkitë nuk paraqesin pranë Ministrisë së Financave kërkesa buxhetore/financiare për të ofruar shërbime sipas VKM nr. 518/2018, në mënyrë të pavarur dhe pa u kushtëzuar nga financimi i MSHMS.

Kjo do të thotë se, në praktikë, ofrimi i shërbimeve sociale mbetet i varur kryesisht nga fondet e transferuara nga buxheti i shtetit përmes Fondit Social, ndërsa iniciativat për financim të pavarur nga buxhetet vendore janë të kufizuara ose mungojnë.

MUNDËSITË TEKNIKE PËR PLANIFIKIM VENDOR

Ministria e Financave ka sqaruar gjithashtu se, në kuadër të strukturës së produkteve standarde sipas programeve buxhetore, është krijuar një produkt specifik në programin 10430 "Përkujdesja Sociale":

"Shërbime sociale për grupet në nevojë të financuara nga Fondi Social"

Ky produkt u mundëson bashkive të planifikojnë fonde nga buxhetet e tyre për mbështetjen e shërbimeve sociale, duke krijuar një bazë teknike për bashkëfinancim vendor dhe për integrimin e shërbimeve të Fondit Social në buxhetet vendore.


Megjithatë, MF konfirmon se aktualisht vetëm 18 bashki përdorin metodologjinë e re të buxhetimit në nivel produkti, pa specifikuar se cilat janë këto bashki. Për rrjedhojë, mbetet e pamundur të identifikohen konkretisht projektet e Fondit Social që financohen nga buxheti vendor, pasi shumica e bashkive vazhdojnë t'i buxhetojnë shpenzimet për përkujdesjen sociale në një program të vetëm, pa ndarje sipas produkteve apo projekteve specifike.

Kjo situatë kufizon transparencën financiare dhe e bën të vështirë gjurmimin e kontributit real të buxheteve vendore në financimin e shërbimeve sociale.

KRAHASIMI ME RAPORTIMET E BASHKIVE

Në ballafaqim me përgjigjet e bashkive, situata paraqitet e fragmentuar:

- Rreth 32 bashki konfirmojnë se kanë bërë parashikime buxhetore për periudhën 2026–2028, por pa dhënë vlera konkrete financimi;
- 9 bashki nuk kanë siguruar informacion mbi planifikimin buxhetor;



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

- 7 bashki raportojnë se nuk kanë parashikuar fonde për projektet e Fondit Social në buxhetin afatmesëm 2026–2028;
- Vetëm 3 bashki – Tirana, Librazhdi dhe Delvina – kanë paraqitur vlera konkrete të parashikimeve buxhetore për shërbimet sociale.

Këto të dhëna tregojnë se planifikimi financiar për shërbimet sociale mbetet kryesisht deklarativ dhe jo i strukturuar në mënyrë të matshme. Mungesa e vlerave konkrete kufizon ndjeshëm mundësinë për të vlerësuar nivelin real të angazhimit financiar të bashkive dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve në afatmesëm.

VARËSIA NGA FONDI SOCIAL

Analiza tregon se Fondi Social vazhdon të jetë burimi kryesor i financimit për një pjesë të konsiderueshme të shërbimeve sociale në nivel vendor. Shërbimet e reja të miratuara në vitin 2025 janë financuar pothuajse tërësisht nga fondet qendrore, ndërsa për shërbimet vijuese mungon transparenca mbi vijueshmërinë e financimit.

Në mungesë të bashkëfinancimit të strukturuar vendor dhe të parashikimeve buxhetore të qarta, shërbimet sociale mbeten të varura nga ciklet vjetore të financimit dhe nga prioritetet e buxhetit qendror.

QËNDRUESHMËRIA E SHËRBIMEVE SOCIALE


Qëndrueshmëria e shërbimeve sociale nuk lidhet vetëm me sigurimin e fondeve, por edhe me integrimin e tyre në politikat vendore dhe në strukturat buxhetore të bashkive. Në rastet kur shërbimet janë të përfshira në Planet Vendore Sociale dhe të buxhetuara në mënyrë të rregullt, ekziston një bazë më e fortë për vijueshmëri.

Megjithatë, për periudhën 2026–2028, mungesa e planifikimit të detajuar financiar nga shumica e bashkive tregon se qëndrueshmëria e shërbimeve mbetet e brishtë dhe e paqartë në afatmesëm.

PËRMBLEDHJE E KATEGORIVE KRYESORE TË PËRFITUESVE


- Të moshuarit dhe personat e vetmuar – Pothuajse të gjitha bashkitë raportojnë të moshuarit si kategori vulnerabël që ka nevojë për mbështetje, veçanërisht ata që janë të vetmuar ose pa përkrahje familjare.
- Personat me aftësi të kufizuara – Një grup tjetër i madh që përfiton nga shërbimet sociale janë personat me aftësi të kufizuara, përfshirë të verbërit, invalidët e punës dhe personat me çrregullime të rënda fizike ose mendore.
- Gratë dhe vajzat viktime të dhunës – Shumë bashki raportojnë si përfitues gra dhe vajza që janë viktime të dhunës në familje, shpeshherë duke përfshirë edhe viktimat e trafikimit.
- Fëmijët dhe të rinjtë në nevojë – Përfshijnë fëmijët jetimë, ata në familje kujdestare, fëmijët me aftësi të kufizuara, dhe fëmijët e braktisur ose në rrezik të lartë përjashtimi social.
- Familjet në vështirësi ekonomike – Një kategori e gjerë që përfshin familjet pa të ardhura, familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që kanë vështirësi të theksuara social-ekonomike.
- Komuniteti Rom dhe Egjiptian – Ky komunitet raportohet si vulnerabël në disa bashki, duke përfshirë ata që jetojnë në kushte të rënda sociale dhe ekonomike.
- Individë në situata të veçanta risku – Përfshin të pastrehët, personat me varësi nga substancat, emigrantët e kthyer me probleme sociale, dhe komuniteti LGBTI në disa bashki.

Disa bashki kanë një listë të gjerë kategorish që përfitojnë nga shërbimet sociale, ndërsa të tjera nuk raportojnë fare kategori vulnerabël ose kanë informacione të mangëta. Kjo sugjeron mungesë standardizimi në politikat e identifikimit dhe mbështetjes.



Aneks 1 - Lista e Projekteve Bashkia Shkodër

Investime me fondet e qeverisë				
Nr.	Investime te kryera	Periudha e Realizimit	Statuti i Perfundimit	Financimi
1	Rikualifikim "Godina e Merkates Rus"	2025	Ne proces tenderimi	MBZHR + Bashkia Shkoder
2	Nderhyrje ne hyrje te Shkodres dhe rikualifikim i bregut perendimor te liqenit te Shkodres (Faza I)	2025	Ne zbatim	BERZH + BE
3	Nderhyrje ne hyrje te Shkodres dhe rikualifikim i bregut perendimor te liqenit te Shkodres (Faza II)	2025	Ne zbatim	BERZH + BE
4	Nderhyrje per permiresimin e Strukturave mbrojtese, veprave te artit ne aksin rrugor Kir - Lotaj - Nderhysaj, bashkia Shkoder	2024-2025	Ne zbatim	FSHZH
5	Permiresimi i bllokut te banimit "Pallati me hark prane Isa Boletinit"	2025	Ne zbatim	Agjencia per Eficencen e Energjise
6	Rikonstruksioni i rruges "Ura e Bunes Shiroke"	2025	Ne zbatim	FSHZH + BERZH
7	Rikonstruksioni i rruges "Shiroke - Zogaj - Kufti, ndertim sistemi te Ujesjelles - kanalizime Zogaj - Shiroke	2024-2025	Ne zbatim	BERZH + BE
8	Projekti "Dua te luajme"		Ne proces	FSHZH
9	Permiresimi i shtresave rrugore ne disa segmente rrugore ne Bashkine Shkoder.	2024-2025	Ne zbatim	FSHZH
10	Rikualifikimi Urban Zdrate	2024-2025	Ne zbatim	FSHZH
11	Rikualifikimi Hyrja e Shkodres, Ura e Bahcallekut	2024-2025	Ne zbatim	ARRSH
12	Muzeumi i Navigimit	2025-2026	Ne zbatim	BERZH
Investime me Bashkefinancim				
13	Rikonstruksion rruga "Roza Lejn + Degezime"	2025-2026	Ne zbatim	MEKI + Bashkia Shkoder
14	Rikualifikim "Godina e Merkates Rus"	2025-2026	Ne proces tenderimi	MBZHR + Bashkia Shkoder
Investime me Buxhetin e Bashkise				
15	Rikonstruksion rruga "Fshati Golem"	2024-2025	Ne zbatim	Perfunduar
16	Rikonstruksion rruga "Pjetrushë" (Grude e re)	2024-2025	Ne zbatim	Bashkia Shkoder
17	Rikonstruksion rruga "Selim Coba"	2025-2026	Ne proces	Bashkia Shkoder
18	Rikonstruksion rruga "Vekshar"	2025-2026	Ne proces	Bashkia Shkoder
19	Rikonstruksion rruga "Martin Camaj"	2025-2026	Ne proces	Bashkia Shkoder
20	Rikonstruksion rruga "Tafilica"	2025-2026	Ne proces	Bashkia Shkoder
21	Rikonstruksion rruga "Bregu i detit", Velipoje	2025-2026	Ne proces	Bashkia Shkoder



Aneks 2 - Lista e Projekteve Bashkia Shkodër

Më poshtë përgjigjja zyrtare nga Bashkia Korçë në lidhje me projektet


INVESTIME PUBLIKE

1. Rikonstruksion i shkollës dhe ndërtimi i palestrës i shkollës 9-vjeçare "Sotir Gurra", - Bashkëfinancim Ministria e Arsimit dhe Sportit + Bashkia Korçë (në proces)
2. Rehabilitimi i Qendrës Inovative dhe Kreative për Fëmijë – Faza I dhe Faza II - Donatorë
3. Termoizolimet e pallateve: Gjatë vitit 2025 është ndërhyrë me këto investime në 7 objekte, në lagjet 14 dhe 16. - FSHZH (përfunduar)
4. Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete në nevojë.

Investimet në këto banesa janë punime për rikonstruksionin e çatisë, tarracës, hidroizolimi, etj. Gjatë vitit 2025 është ndërhyrë me këto investime në 13 objekte, në lagjet 4, 8, 9, 10, 14, 17 dhe 18: - Bashkia + Ish MEKI sot Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (në proces)

- L.17, Rr.Sabaudin Kacidhja
- L.4, Rr.Koli Çeku, nr.40
- L.4, Rr.Todi Vogli, nr.4
- L.17, Rr.Ajet Gjindolli, nr.119
- L.17, Rr.Këngëtarja Qerime, nr.16 dhe 21
- L.18, Rr.Gjerasim Qirjazi, nr.8
- L.17, Rr.Xhafer Cenko Lubonja, nr.8
- L.10, Rr.Theodhor Kavalioti, nr.3
- L.10, Rr.Pano Xhamballo, nr.40
- L.14, Rr.Nexhip Vinçani, nr.9
- L.8, Rr.Ramadan Isak, nr.2

- L.9, Rr.Kristo Luarasi, nr.2 në 7 objekte, në fshatrat:
 - Rr. Saraniqi, nr.12, Fshati Dishnicë
 - Rr.7 Marsi, nr.30, Voskop
 - Rr. Rinia, nr.7, Drenovë
 - Në fshatin Barç
 - Rr. Rinia, nr.11, Drenovë
 - Rr. Haki Mborja, nr.35
 - Rr. Bala, nr.3, Voskop
5. Shtrim me asfalt miks, rruga "Thoma Nashi" – Bashkia (përfunduar)
 6. Ndërhyrje për sistemimin e shtresës së dytë të varrezave të qytetit – Bashkia – (në proces)
 7. Rehabilitim i godinës së shërbimit mbështetës për familjen dhe fëmijët – Donatorë – (përfunduar)
 8. Rikonstruksion i çatisë së "Qendrës mbështetëse për familjen dhe fëmijët" - Bashkia – (përfunduar)
 9. Punime meremetimi të qendrës komunitare të komunitetit Rom dhe Egjiptian, Korçë dhe të Qendrës për moshën e tretë Bulgarec – Bashkia – (përfunduar)
 10. Punime termoizolimi të fasadës së brendshme të pallatit në lgj.12. blv. "Shën Gjergji", nr.10, (ish mapo), Korçë. – Bashkia (në proces)
 11. Shtrim i rrugës Todi Vogli, Kristo Luarasi – FSHZH – (përfunduar)
 12. Rikonstruksion i Pallatit të Sportit "Tamara Nikolla", shtese kati, - FSHZH. (në proces)
 13. Rikonstruksion i Pallatit të Sportit "Tamara



Nikolla", shtesë kati, Punime fasade. - Bashkia + Ish Ministria e Arsimit dhe Sportit (në proces)

14. Laborator i industrisë kreative (në qytetin e Korçës) dhe muzealizimi inovativ i qendrës turistike Voskopojë, " Korçë. - FSHZH (përfunduar)
15. Punime në hapësira Cube France në GADK - Donatorë (përfunduar)
16. Fasada e oficerave - FSHZH - (përfunduar)

INVESTIME NË NJËSITË ADMINISTRATIVE:

NJËSIA ADMINISTRATIVE BULGAREC

1. Punime meremetimi të Qendrës për moshën e tretë Bulgarec. - Bashkia - (përfunduar)
Sistemi i përrënjeve nga Emergjencat Civile - financimi nga Bashkia Korçë + Ministria e Mbrojtjes (përfunduar)
2. Sistemim dhe veshje me beton i përroit të fshatit Porodinë, me gjatësi 655 ml
3. Sistemim dhe veshje me beton përroi Bulgarec, me gjatësi 135 ml dhe vendosje tombinosh.
4. Sistemim dhe veshje me beton kanali të rruga e Repartit , fshati Bulgarec.
5. Përmirësim i shtresave rrugore Lumalas - rruga e Teqesë, me gjatësi 976 ml. - FSHZH (përfunduar)
6. Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete në nevojë. Investimet në këto banesa janë punime për rikonstruksionin e çatisë, tarracës, hidroizolimi, etj : - Bashkia + Ish MEKI sot Misnitria e Ekonomisë dhe Inovacionit (në proces)

Gjatë vitit 2025 është ndërhyrë me këto investime në 2 objekte, në fshatrat:


- Rr. Saraniqi, nr.12, Fshati Dishnicë - Artian Çuka
- Në fshatin Barç - Fatmir Plloça

NJËSIA ADMINISTRATIVE DRENOVË

1. Sistemim i qendrës së Drenovës - FSHZH - (përfunduar)
2. Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete në nevojë.

Investimet në këto banesa janë punime për rikonstruksionin e çatisë, tarracës, hidroizolimi, etj Gjatë vitit 2025 është ndërhyrë me këto investime në 7 objekte, në fshatrat: : -Ivestimi Bashkia + Ish MEKI sot Misnitria e Ekonomisë dhe Inovacionit (në proces)

- Rr. Rinia, nr.7, Moravë - Eleni Pojan (në proces)
 - Rr. Rinia, nr.11, Moravë - Mimoza Karejmani (në proces)
 - Rr. Haki Mborja, nr.35, Mborje - Luljeta Axhi (në proces)
3. Shtrim me kalldrëm i rrugëve të fshatit Mborje, në 6 rrugë, me gjatësi totale prej 1535 m2 - Bashkia (NSHP) - (në process)
 4. Shtrim me asfalt dhe sistemim trotuari, rruga "Minatori", Moravë, në një gjatësi lineare prej 730 m² asfalt dhe 230 m2 troturare - Bashkia (NSHP) (në proces) Rrugët e shijes - FSHZH (ne proces)Ku përfshihen:
 5. Shtëpia e Manave (Ish shkolla Drenove) fshati Drenove Një. Adm. Drenove FSHZH (në proces)
 6. Shtëpia e Qershive (Ish shkolla Qatrom) fshati Qatrom Një. Adm. Drenove FSHZH (në proces)
 7. Shtëpia e Kemboreve (Ish shkolla Boboshtice) fshati Boboshtice Një. Adm. Drenove FSHZH (ne proces)
 8. Shtëpia e Zahireve (Ish shkolla Polene) fshati Polene Një. Adm. Voskop FSHZH (ne proces)
 9. Ferma e dijes dhe agroturizmit të mollëve në fshatin Qatron -FSHZH (në process)
 10. Shtigje malore aventurore - FSHZH (në proces)
 11. Sistemim i qendrës së Drenovës - FSHZH - (përfunduar)



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

12. Ndërtimi i godinave dhe parkut të " Poli I festivaleve dhe industrisë kreative" Drenovë, -FSHZH, (në proces)

NJËSIA ADMINISTRATIVE VOSKOPOJË

1. Muzealizimi inovativ i qendrës turistike Voskopojë. – FSHZH (përfunduar)
2. Sistemim dhe veshje me beton përroi Gjonmadh, me gjatësi 210 ml,vendosje tombino, ndërtim prite malore me gabiona. – financimi nga Bashkia Korçë + Ministria e Mbrojtjes (përfunduar)
3. Rehabilitim i digës së ujëmbledhësit të Gjonmadhit, financimi nga Bashkia Korçë + Ministria e Mbrojtjes (përfunduar)

NJËSIA ADMINISTRATIVE VITHKUQ

4. Shtrim me kalldrëm i rrugëve të lagjeve "Saraq", "Dukas", "Grekas", të fshatit Vithkuq – Bashkia - (në proces)
5. Ndërtim lere plastmasi dhe korite në kullota, "Mali i Gelos" dhe "Fusha e Pusit". – Donatore (TAP)- (përfunduar)
6. Sistemim dhe veshje me beton i përroit të fshatit Lubonjë, me gjatësi 680 ml, ndërtimi i 4 urave që lidh dy pjesët e fshatit. – Bashkia + Ministria e Mbrojtjes për Emergjencat civile (përfunduar)

NJËSIA ADMINISTRATIVE VOSKOP

7. Sistemim dhe veshje me mur guri përroi Polenë, me gjatësi 150 ml – Bashkia + Ministria e Mbrojtjes Emergjencat civile (përfunduar)
8. Mure mbajtes në vend-derdhjen e përroit të Dvoranit në lumin e Dunavecit. – Bashkia + Ministria e Mbrojtjes Emergjencat civile (përfunduar)
9. Sistemim dhe veshje me beton përroi Goskovë Lart– Bashkia + Ministria e Mbrojtjes Emergjencat civile (përfunduar)
10. Përmirësim i shtresave rrugore Polenë -Dërsnik, me gjatësi 4 + 477 ml. - FSHZH (përfunduar)
11. Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete në nevojë. Investimet në këto banesa janë punime për rikonstruksionin e çatisë, tarracës, hidroizolimi, etj - Bashkia + Ish MEKI sot Misniria e Ekonomise dhe Inovacionit (në proces)


Gjatë vitit 2025 është ndërhyrë me këto investime në 2 objekte:

- Rr.7 Marsi, nr.30, Voskop – Bledar Seidolli
- Rr. Bala, nr.3, Voskop – Gjenç Dilka

12. Ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore në fshatrat Voskop, Lavdar, Turan (investimi nga Donatore) (në process)

NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAJ

13. Sistemim dhe veshje me beton përroi Kamenicë, – Bashkia + Ministria e Mbrojtjes Emergjencat civile (përfunduar)




Aneks 3 - Lista e Projekteve Bashkia Fier

Më poshtë përgjigjja zyrtare e Bashkisë Fier

Në përgjigje të kërkesës suaj lidhur me informacionin mbi projektet e zbatuara në Bashkinë Fier, ju bëjmë me dije se gjatë vitit 2025, projektet e ndjekura nga Drejtoria e Integritimit janë roce poshtë:

1. "Mobilimi i Zjarrfikëses Fier"
 - Statusi i zbatimit: I përfunduar
 - Burimi i financimit: Donatorë
2. "SKYHIGH RINOR – Projekti I Hapësirës së Rinisë që Shkëlqen mbi Qytet"
 - Statusi i zbatimit: I përfunduar
 - Burimi i financimit: Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe Bashkia Fier
3. "BluNew"
 - Statusi i zbatimit: Në rocess zbatimi
 - Burimi i financimit: Donatorë dhe Bashkia Fier
4. "Circle"
 - Statusi i zbatimit: Në rocess zbatimi
 - Burimi i financimit: Donatorë dhe Bashkia Fier
5. "Ariadne"
 - Statusi i zbatimit: Në rocess zbatimi
 - Burimi i financimit: Donatorë dhe Bashkia Fier

Lidhur me referencat online, ju informojmë se të dhënat për projektet e sipërcituara janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë FIER.



Aneks 4 - Lista e Projekteve Bashkia Vlorë

Më poshtë përgjigjja zyrtare e Bashkisë Vlorë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EVROPIAN DHE DIASPORËS

Lënda: Të dhëna për projektet e Bashkisë Vlorë me financim të huaj për vitin 2025–2026

1. TITULLI CIRCUS -PROGRAMI INTERREG IPA-ADRION00177

“Strategjitë e ekonomisë qarkulluese, planet e veprimit dhe zgjidhjet për tranzicionin e sistemeve agroushqimore në Komunitetet bregdetare te zones ADRION”

Bashkia Vlore vijon për vitin 2026 implementimin e projektit CIRCUS. Përgjatë periudhës së parë, Bashkia përgatiti një strategji dhe plan veprimi lokal te ekonomise qarkulluese. Bashkia Vlore do te identifikoj zgjidhjet e ekonomisë qarkulluese për projektin pilot dhe do testojë të paktën një projekt pilot dhe do të hartoj raportin e rezultateve të testimit të implementimit të këtij të fundit. Me një bashki tjetër partnere do te krijohet Twin Lab për të zhvilluar program bashkëpunimi të detajuar. Do të vijohet me shkëmbim zgjidhjesh inovative të testuara gjatë projektit pilot me Bashkinë, pjese e Laboratorit Binjak (Twin-Lab), duke eksploruar përshtatshmërinë e ndërsjellë dhe për të zhvilluar një zgjidhje të përbashkët. Universiteti Jonian do te mbeshtese në hartimin e dokumentit të formalizimit të zgjidhjeve të zhvilluara .

2. TITULLI PREVENT- PROGRAMI INTERREG IPA00419 ADRION

‘Reduktimi i ndotjes dhe paralajmërimi i hershëm për Ekosistemet Vulnerabël në territoret Adriatik-Jon’


Projekti vijon implementimin dhe trajton sfidën e përbashkët të ndotjes detare në rajonin Adriatiko-

Jonian. Kjo sfidë përkeqësohet nga ndryshimet klimatike dhe përbën një kërcënim të konsiderueshëm për rajonin ekosistemet, komunitetet dhe ekonominë. Projekti synon të zhvillojë mjete inovative dhe metodat për zbulimin e hershëm, parandalimin dhe menaxhimin mbeturinave detare. Duke qenë se Vlorë është një qytet me një vijë bregdetare shumë të gjatë, do të jetë një nga zonat pilot për ndotjen në vend, monitorimin dhe vendosjen e teknologjive të paralajmërimit dhe parashikimit të hershëm. Vlorë do të jetë gjithashtu pjesë e aktiviteteve nga të cilat do të kontribuojë dhedo të peftoje strategjinë (dokument) për uljen e ndotjes detare. Bashkia Vlore do të kontribuojnë në mënyrë aktive në menaxhimin dhe koordinimin e projektit, si dhe aktivitetet e komunikimit dhe të dukshmërisë.

3. TITULLI: REVCOM- PROGRAMI IADSA II ITALIAN-ALBANIAN DEBT FOR DEVELOPMENT SWAP AGREEMENT

“Rindërtimi i tregut të hapur të qytetit të Vlorës në mbështetje të praktikave më të mira për promovimin e bujqësisë lokale dhe lehtësimin e tregtisë industriale”

Projekti parashikon hartimin e një masterplani të të gjithë hapsirës të quajtur si “Tregu i Madh i Vlorës” në funksion të përmirësimit të infrastrukturës, promovimit të turizmit, akses dhe kushte të përmirësuar për tregtimin e produkteve bujqësore dhe industriale. Me qëllimin për të nxitur zhvillimin e qndrueshëm lokal, projekti vlerësohet si një



risi në kuadër të transformimit infrastrukturor të territorit të Bashkisë Vlorë duke ecuar në një linjë më dokumentet strategjike si Programi Qeveritar 2021-2025 të Rikualifikimit Urban dhe Planit Vendor të Zhvillimit të Bashkisë Vlorë.

4. TITULLI : UNITING ROUTES ,PROGRAMI CERV 2024, NETWORK OF TOWNS, EUROPEAN EDUCATION AND CULTURE EXECUTIVE AGENCY, BE

Projekti drejtohet nga Bashkia e Angrit, Itali dhe ka ne partneriret disa bashki dhe organizata nga shtete si Spanja, Portugalia dhe Italia. Bashkia Vlore eshte partnere ne keteprojekt duke perfaqesuar ne kete program shtetin Shqiptar. Projekti "Uniting Routes: Netëorking for Environmental Sustainability and Share Responsibility" fokusohet në ndërtimin dhe konsolidimin e partneriteteve midis qyteteve, për të lejuar qytetarët të marrin pjesë aktive në diskutime dhe veprime për të adresuar ndryshimet klimatike dhe për të promovuar shkëmbimin e praktikave më të mira midis autoriteteve lokale. Projekti propozon krijimin e një rrjeti të autoriteteve lokale evropiane të gatshme për të bashkëpunuar në çështjet që lidhen me ruajtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore, nëpërmjet shkëmbimit të praktikave më të mira dhe zgjidhjeve novatore, për të promovuar mbrojtjen e mjedisit dhe qëllimet e BE-së.

5. TITULLI SPICE SA-300384 ,PROGRAMI INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC, BE

Bashkia Vlorë, për herë të parë në rolin e Lead Partner nënjë projekt me financim të huaj, me fokus promovimin e punësimit dhe sipërmarrjen tek të rinjtë, gratë përmeszhvillimit të aftësive ne sektorët e ushqimit dhe verës, duke nxitur krijimin e mikrondërmarrjeve inovative dhekonkurruese që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal dhe në përmirësimin e trashëgimisë kulturore gastronomike. Do të mundësohet krijimi laboratorit i gatimit ne Markaton e Peshkut.


6. TITULLI RELOAD 3 - PROGRAMI RAJONAL PËR DEMOKRACINËVENDORE, FINANCIAR NGA BE DHE ZBATOHET NGA UNDP SHQIPËRI

Bashkia Vlorë është një ndër bashkitë përftuese. Programi ka për qëllim të forcojë demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integritit evropian duke kontribuar në përshpejtimin e zhvillimit të qëndrueshëm të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Objektiv i specifik i programit është të forcojë koordinimin mes bashkisë Vlorë dhe Organizatave të Shoqërisë Civile , duke kontribuar në krijimin e një mjedisi më të favorshëm për OSHC-të të mbështetur nga financime publike transparente , njëkuadër ligjor mbështetës dhe një angazhim qytetar të lartë nëhartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave. Një tjetër objektiv specifik është mbështetja e bashkisë Vlorë me aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të stafit , asistencë teknike dhe grant gjatë zbatimit të thirrjeve publike të përbashkëta.

7. TITULLI SACRED TRAVELS4 GROWTH- PROGRAMI ERASMUS _EDU-2025-CBHE-STRAND-2, P.NO:101238053

Projekti Sacred_Travels_4_Growth është hartuar për të adresuar boshllëqet kritike në turizmin e turizmit religjioz dhe zhvillimin e fuqisë punëtore në Shqipëri, Afrikën e Jugut, Indi dhe Moldavi. Në përputhje me objektivat më të gjera, projekti aspiro të prezantojë qasje inovative në ofertën e arsimit të lartë në turizmin fetar/kulturor që rrit rëndësinë e tij për tregun e punës dhe shoqërinë. Në këtë ndjekje, projekti mbështetet në modelet dhe praktikën më të mira evropiane, mësimin nga kolegët dhe ekspertizën ndërdisiplinore, duke nxitur kështu reformat institucionale në ofertat përkatëse të arsimit të lartë që pritet të kenë ndikim afatgjatë përtej kohëzgjatjes së projektit.

Bashkia Vlore, është një ndër 17 partnerët ne këtë projekt, dhe prirë të ndaj me partneret eksperiencën e saj në sektorin e turizmit , si një ndër katalizatorët kryesorë të ekonomisë sëqytetit.



RAPORT MONITORIMI

TRANSPARENCA E 10 BASHKIVE DHE MATJA E 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKVE

8. TITULLI VR DIGI VET- PROGRAMI ERASMUS –EDU -2023-CB-VET

Bashkia Vlorë do të jetë në rolin e institucionit vendor mbështetës për ngritjen e Labororit VR në Shkollën Profesionale “Pavarësia” dhe do të ndjekë të gjitha aktivitetet që do të realizohen deri në realizimin e krijimit të labororit VR në Vlorë.

9. TITULLI AQUA NOSTRA – PROGRAMI AICS

Angazhimi i Bashkisë Vlorë, si një ndër partnerët e këtij projekti strategjik, me fokus sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza në një nga njësitë administrative të territorit të bashkisë Vlorë (ky i fundit angazhim financiar në projekt i Ujësjetës Kanalizime Sh a Vlorë); lidhet me organizimin e një fushatë ndërgjegjësimi dhe informimi.


10. TITULLI ART4SEA”- MELTING ART, CREATIVITY AND MARINE SCIENCES TO FOSTER OCEAN LITERACY IN THE MEDITERRANEAN AREA” NGA PROGRAMI EVROPA KRIJUESE, FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN

Me një kohëzgjatje 36 muaj, me Lider 3D RESEARCH SRL, Itali dhe Bashkia Vlorë si një ndër

shtate partneret e përfshirë ART4SEA synon të krijojë një program bashkëpunimi ndërnacional dhe ndërdisiplinor që përfshin artistë, profesionistë krijues, media dixhitale ekspertë dhe shkencëtarë detarë për të bashkëprodhuar një kombinim të veprave fizike dhe dixhitale të artit të fokusuar në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për degradimin e Oqeanit dhe ndryshimet klimatike, duke i motivuar kështu njerëzit që të marrin një sjellje më miqësore me mjedisin në jetën e tyre të përditshme. Katër ekspozita dhe një ngjarje madhështore finale do të organizohen në kombinim me seminare dhe iniciativa të tjera pjesëmarrëse të adresuara për të maksimizuar angazhimin publik dhe për të përfshirë gamën më të gjerë të artisteve- një nga keto aktivitete do të zhvillohet në Bashkinë e Vlores. Bashkia Vlorë është një ndër destinacionet kryesore turistike në makro-rajonin ADRION. Nevoja për të zgjeruar sezonin turistik dhe për të diversifikuar ofertën turistike duke tërhequr më shumë kategori turistike ka qenë qëllimi në përfshirjen në këtë program. Projekti përfundon në janar 2026.

Për një informacion më të detajuar mund të konsultoheni me link më poshtë:

<https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2025/12/Buxheti.pdf>



Ky raport u mbështet nga National Endowment Democracy (NED)

Raporti u punua nga: Erta Marku dhe Erisa Proko

